



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 8 Akti

Nr. 46 Vendimi

Tiranë, më 24.07.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Olsi Komici
Roland Ilia
Pamela Qirko

Kryesues
Anëtar
Relatore

me sekretare gjyqësore znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, në datat 20.07.2018 2018, ora 13:00 dhe 24.07.2018, ora 12:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Xhezair Zaganjori, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioneren Pamela Qirko, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Xhezair Zaganjori, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V E R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Xhezair Zaganjori është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si kryetar i Gjykatës së Lartë Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. Duke qenë se z. Xhezair Zaganjori është kryetar i Gjykatës së Lartë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit me përparësi.

Subjekti i rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, në periudhën 2003 - 2013 ka ushtruar funksionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Në periudhën 2013 e aktualisht ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (me poshtë referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 01.12.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr.1, i përbërë nga komisionerët Roland Ilija, Olsi Komici dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 06.11.2017 (23 fletë), në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

5. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2017, (deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 30.01.2018), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori*

6. Inspektorati i Lartë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2017.

7. Me vendimin nr. 1, datë 13.11.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Xhezair Zaganjori, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi me mirëkuptim kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin z. Olsi Komici. Në këtë mbledhje, të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit.

8. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 26.06.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t' u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 26.06.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 16.07.2018.

11. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 16.07.2018.

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 20.07.2018, ora 13:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Z. Xhezair Zaganjori ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë

vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar Vendimit nr. 2/2017^[1] të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit, është kryer proces i plotë hetimor administrativ nga Komisioni, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raportin e dorëzuar pranë Komisionit; çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; komunikimet me subjektin, si dhe sugjerimet e vëzhguesit ndërkombëtar, për rrethana konkrete në procesin vlerësimit të pasurisë.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklaratimeve të rreme apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë nga ana e Komisionit është bazuar në sa më poshtë:

Lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në Deklaratën-Vetting nga subjekti dhe personat e lidhur

18. Subjekti ka deklaruar apartament banimi, sip. 293 m², Rr. “****”, ap. ***, pjesë e bashkësisë ligjore dhe bashkëpronësi në pjesë ideale me bashkëshorten, kontratë

[1] “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “proces i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

shitblerjeje, pajisur me certifikatë pronësie nr. ***, datë 27.03.2015, me vlerë 5.800.000 lekë.

18.1 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

ZVRPP Tiranë ka konfirmuar pasurinë me sip. 293 m², ZK ***, nr. pasurie ***, Rr. “****”, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, në emër të subjektit dhe bashkëshortes, me shkresat nr. *** prot., datë 31.08.2017, dhe nr. *** prot., datë 28.09.2017.

Lidhur me blerjen e apartamentit, nga hetimi rezulton së është bërë me kontratë shitjeje nr. *** rep., datë 6.10.2001, para noterit, dhe vlera e blerjes rezulton 500.000 lekë.

Referuar përgjigjes së ZVRPP-së Tiranë, aseti është blerë me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me palë shitëse z. H.M. dhe znj. Sh.Z. (gjyshi dhe halla e bashkëshortes së subjektit) dhe palë blerëse znj. N.Z. dhe z. Xhezair Zaganjori, në shumën 500.000 lekë. Sipas sqarimit të dhënë nga vetë subjekti, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, vlera që i ka vendosur apartamentit në kontratën e shitjes është vlera e kostos së ndërtimit të objektit, që i përket asaj periudhe. Sipas subjektit, fillimisht i gjithë pallati i ndërtuar është regjistruar në emër të pronarëve të tokës, z. H.M. dhe znj. Sh.Z., ndërsa me kontratat përkatëse të shitjeve është bërë kalimi prej tyre te katër nipërit dhe mbesat dhe bashkëshortët respektivë. E njëjta situatë paraqitet edhe për pasuritë e mëposhtme, - konkretisht dyqani, bodrumi dhe zyrat, - të cilat janë të ndara në pjesë ideale.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 293 m² (*Deklarata-Vetting, viti 2017*) nuk përputhet me deklarin e parë të bërë për vitin 2003 dhe kontratën përkatëse të shitblerjes (*kontrata e vitit 2001*) për këtë pasuri. Sipas Deklaratës-Vetting, vlera e apartamentit është 5.8 milionë lekë dhe sipërfaqja totale është 293 m², ndërsa sipas deklarin për herë të parë vlera është 7.4 milionë dhe kontrata e shitblerjes është në vlerën 500.000 lekë. Gjithashtu, sipas deklarin në përgjigje të pyetjeve të bëra, subjekti ka deklaruar se për blerjen e pasurisë së paluajtshme ka shpenzuar në total shumën prej 9.1 milionë lekësh.

Burimi i të ardhurave për blerjen e apartamentit është shitja e apartamentit të mëparshëm me vlerë 3.9 milionë dhe pjesa tjetër nga të ardhurat personale dhe qiraja.

Në një vlerësim paraprak, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tri deklarata të ndryshme dhe rezulton një kontratë, e cila nuk korrespondon me deklarinet për pasurinë e blerë, si për vlerat përkatëse, edhe për sipërfaqen. Këto deklarime të ndryshme, si për vlerën, edhe sipërfaqen, nuk justifikohen, për më tepër kur subjekti i rivlerësimit ishte pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë e mësipërme që në vitin 2001 dhe deklarin e parë e ka bërë në vitin 2003.

Sipas përgjigjes së pyetjeve të fundit, subjekti ka deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme ka shpenzuar gjithsej 9.100.000 lekë dhe se për kalimin e pronësisë u zgjodh varianti me kontratë shitjeje me një shumë fikse, simbolike, prej 500.000 lekësh.

Për vlerësimin e çmimit të shitblerjes në qytetin e Tiranës, Komisioni i kërkoi informacion Entit Kombëtar të Banesave (*shkresa nr. ***, datë 17.01.2018*) për marrjen e informacionit mbi kontratat që disponon ky institucion me subjektin e rivlerësimit, si dhe informacion lidhur me të dhënat për çmimin mesatar të kostos së ndërtimit në tregun e lirë për pasuritë e paluajtshme.

EKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 29.01.2018, ka dërguar të dhëna dhe kontratat e lidhura me subjektin e rivlerësimit, të cilat janë të njëjta me të dhënat dhe kontratat e dërguara nga ZVRPP-ja Tiranë. Gjithashtu, ka konfirmuar se kostoja mesatare e shfrytëzimit në tregun e lirë për qytetin e Tiranës për vitin 2000 është 53.400 lekë për metër katror dhe për vitin 2001 është 56.306 lekë për metër katror.

Bazuar në përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, me shkresën nr. ***, datë 05.04.2018, dhe në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” është përcaktuar se kalimi i së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme tatohej sipas:

- Deri në vlerën 2.000.000 - 0.5 % e çmimit të shitjes;
- Deri 4.000.000 lekë - 1 % e çmimit të shitjes;
- Deri 6.000.000 lekë - 2 % e çmimit të shitjes;
- Mbi 6.000.000 lekë - 3 % e çmimit të shitjes.

Pra, deklarimi i çmimit të shitjes në vlerën e kontratës prej 500.000 lekësh dhe jo sipas vlerës reale të blerjes së pasurisë së paluajtshme ka sjellë pasoja financiare dhe palët kontraktore kanë pasur për qëllim shmangien e detyrimeve përkatëse.

Për periudhën në të cilën është lidhur kjo kontratë shitblerjeje, rezulton se nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për caktimin e çmimit të referencës. Në këto kushte, është më se i qartë vullneti i palëve kontraktore për t’iu shmangur detyrimeve tatimore. Por, kjo shmangie është kryer duke shfrytëzuar boshllëqet ligjore në legjislacion, duke sjellë për pasojë evazion tatimor të ligjshëm. Subjekti nuk mund të penalizohet për shkelje të një dispozite ligjore që nuk ekziston.

Mbi pasaktësitë e konstatuara nga Komisioni gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit është pyetur dhe i është kërkuar të japë shpjegime dhe prova. Në përfundim të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me mospërputhjet e deklarimeve ndër vite për këtë apartament dhe deklarimeve në Deklaratën-Vetting.

18.2 Arsyetimi ligjor

- Nga hetimi administrativ ka rezultuar e provuar se ndërtimi i godinës disakatëshe (*objekt hetimi*) është bërë me kontributin e përbashkët të katër familjeve në tokën truall, me sipërfaqe 250 m², të njohur dhe kthyer në vitin 1994 nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave trashëgimtarëve të ish-pronarëve të shpronësuar, z. H. M. dhe znj. Sh. Z., që janë respektivisht gjyshi dhe halla e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

- Katër fëmijët e përfituesve të pronës, - konkretisht bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. N. Z., vëllai i saj, z. A. M., znj. M. Z. dhe znj. V. Z., bashkë me bashkëshortët respektivë, - kanë aplikuar në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë për të miratuar një leje ndërtimi për një objekt shërbimi dhe banimi disakatësh. Më datë 03.05.1995 është miratuar leja e ndërtimit dhe të katërta familjet kanë nisur të bashkëkontribuonin për ndërtimin e objektit.
- Me marrëveshje ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë dhe pronarëve të truallit, të paformalizuar, por të formësuar me veprime konkludente, ata kanë rënë dakord për krijimin e sendit të ri dhe për ndarjen e tij më pas në katër pjesë të barabarta, të cilat do të shërbenin për strehimin e secilës familje dhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në pjesët e objektit të destinuara për shërbim.
- I gjithë objekti rezulton të ketë mbaruar së ndërtuari në gusht të vitit 1997 dhe pikërisht në këtë datë është bërë funksional, sipas destinacionit ekonomik dhe social. Rezulton se që nga momenti kur sendi është bërë funksional, secila prej familjeve ka lidhur kontrata furnizimi me ujësjellësin dhe me Korporatën Elektroenergjëtike Shqiptare sh.a., për furnizimin me ujë dhe me energji elektrike.
- Punimet e objektit pesëkatësh kanë përfunduar kryesisht nën mbikëqyrjen e znj. M. H., por edhe nga familjarët që do të bëheshin bashkëpronarë. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me bashkëshorten, në këtë kohë kanë qenë në Gjermani. Megjithatë, verbalisht dhe me veprime konkludente ata kishin autorizuar familjarët e tyre për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim ndërtimin e objektit.
- Rezulton se kati i parë i objektit i është dhënë me qira në shtator të vitit 1997 “****”-it, me qëllim për t’u shfrytëzuar si bibliotekë, duke qenë se kishte edhe një sipërfaqe të mjaftueshme, prej 250 m². Ndërsa katër katet e tjera, me marrëveshje dhe me veprime konkludente të secilës familje, janë marrë në dorëzim dhe janë ndarë, duke u vendosur secila familje për strehim aty. Të katërta familjet në fjalë rezulton të kenë shitur apartamentet që kishin më parë dhe, sakaq, kanë vendosur të banonim aty. Edhe dy trashëgimtarët e ish-pronarëve të shpronësuar pa të drejtë kanë jetuar aty derisa kanë ndërruar jetë.
- Kati i parë rezulton të ketë shërbyer si bibliotekë, njëherazi njësi shërbimi e dhënë me qira, deri në vitin 2006, vit në të cilin ka përfunduar marrëdhënia juridike e qirasë me “****”-in. Qiramarrësit në vijim e kanë ndryshuar destinacionin ekonomik të kësaj njësie shërbimi, sipas aktivitetit ekonomik që ata kanë zhvilluar aty. Nga kjo shpjegohet se pse subjekti i deklaramentit, në disa deklarata pasurie e quan këtë njësi shërbimi si bibliotekë dhe, në disa të tjera, si dyqan i dhënë me qira.
- Ndërkaq, bodrumi i banesës dhe zyra e krijuar për zhvillimin e aktiviteteve të shërbimit në këtë objekt, me sipërfaqe 60 m², nuk rezulton të jetë ndarë as me marrëveshje faktike, por rezulton të jetë lënë në bashkëpronësi ideale dhe në shfrytëzim të përbashkët.
- Sendi i ri i krijuar nga zhvillimi urban i pronës tokë truall ka ekzistuar i formësuar sipas destinacionit social dhe ekonomik që në gushtin e vitit 1997, dhe nga ky fakt arrihet në përfundimin se pikërisht ky është edhe momenti ideal juridik se kur është fituar pronësia e secilit prej bashkëpronarëve bashkëkontributorë. Nga kjo konkludohet se mënyra e

fitimit të pronësisë është jo e prejardhur, por origjinale, sikurse Kodi Civil parashikon për fitimin e pronësisë me bashkim dhe me përzierje, në nenin 173 të tij.

- Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëpronarët respektivë kanë kërkuar vazhdimisht për të kryer regjistrimin e çdo njësie shërbimi dhe banimi të krijuar rishtazi nga zhvillimi urban i pronës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, por ka qenë e pamundur, pasi për arritjen e këtij qëllimi institucioni kërkonte formalisht ekzistencën e një shkrese apo dokumenti ku të materializohej titulli i pronësisë. Në këto kushte, me qëllim arritjen e regjistrimit të pasurisë dhe gëzimin e plotë juridik të saj (*shih nenin 195 të Kodit Civil*), secila prej familjeve bashkëpronare rezulton të ketë realizuar kontrata shitjeje për çdo njësi. Kontratat janë realizuar para noterit në vitin 2001. Këto veprime juridike rezulton të jenë kryer në mënyrë që formalisht të formësohej një titull pronësie, i aftë, sipas Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për të regjistruar pasuritë.
- Nga këto fakte konkludohet se momenti i fitimit të pronësisë nuk është viti 2001, kur janë hartuar kontratat e shitjes formalisht, por viti 1997, kur sendi i ri i zhvilluar urbanisht është përfunduar dhe krijuar.
- Gjithashtu, arrihet në përfundimin se mënyra e fitimit të pronësisë nuk është kontrata e shitjes apo, e thënë ndryshe, nuk kemi të bëjmë me mënyrë të prejardhur të fitimit të pronësisë, por kemi të bëjmë me një mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë. Pronësia mbi sendin e krijuar rishtazi është fituar me bashkim dhe përzierje, sikur parashikon neni 173 i Kodit Civil.
- Më tej, konstatohet se shfrytëzimi i sendit për banim dhe për aktivitet ekonomik nuk ka nisur nga viti 2001, kur janë hartuar formalisht kontratat e shitjes, por ka nisur që nga viti 1997, kur sendi përfundoi së ndërtuari u bë edhe funksional. Ky fakt provohet nga e dhëna se kontrata e qirasë për katin e parë me “***”-in është lidhur në shtatorin e vitit 1997 dhe, që nga kjo kohë, secila nga njësitë e shërbimit dhe banimit është furnizuar rregullisht me ujë dhe me energji elektrike.
- Gjithashtu, konkludohet se momenti i fitimit të pronësisë, qoftë te mënyrat origjinale dhe të prejardhura që ligji parashikon, nuk është veprimi administrativ i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, por është momenti ideal juridik i vërtetimit dhe plotësimit të kushteve ligjore kumulative, vërtetimi i të cilave prodhon pasojat juridike, konkretisht ndërtimi i sendit të ardhshëm. Pikërisht, ky është momenti kur perfeksionohet mënyra origjinale e fitimit të pronësisë me bashkim dhe me përzierje, sipas nenit 173 të Kodit Civil.
- Rezulton se burimi i krijimit të pasurisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, sipas pjesëve takuese që ai me bashkëshorten kanë në bashkësinë ligjore mbi objektin pesëkatësh të ndërtuar në vitin 1997, janë kryesisht të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm (*kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.01.1999, me vlerë 3.900.000 lekë*); të ardhurat personale të të dy bashkëshortëve; dhe të ardhurat nga qiraja e njërive të shërbimit, në ¼-ën pjesë respektive (*vlera 3.5 milionë lekë*).
- Rezulton se të ardhurat për të ndërtuar sendin e përbashkët janë krijuar edhe duke lënë pjesën respektive të kontratës së qirasë me “***” të bashkëpronari që merrej me administrimin e përditshëm të sendit. Përfitimi respektiv nga kjo qira, pa kompensuar

bashkëpronarin tjetër, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, ka nisur nga janari 1999.

- Në pranverën e vitit 1999 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë paguar nga Gjermania edhe shumat 1 milion lekë dhe 1.6 milion lekë për ndërtimin dhe arredimin e njësisë së tyre të banimit në objektin e përbashkët dhe se e gjithë vlera e ndërtimit dhe e arredimit kap shumën prej 5.8 milionë lekësh.
- Një pjesë e të ardhurave në fillimin e ndërtimit, në vitin 1996, ishin tërhequr nga “Volks Bank” në Heidelberg të Gjermanisë, ku subjekti i rivlerësimit ushtronte aktivitetin profesional, - rreth 2.5 milionë lekë, - dhe i janë dhënë bashkëpronarit që merrej me administrimin dhe ndërtimin e sendit që po krijohej.
- Nga aktet e dosjes vërehet se ka një mosrakordim ndërmjet deklarimeve në kohë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kontributit që ai bashkë me bashkëshorten e tij kanë paguar apo shpenzuar për krijimin e pjesëve takuese të sendit të krijuar rishtazi. Kështu, në vitin 2003 vlera e shpenzimeve në deklaratën e pasurisë është deklaruar 7.4 milionë lekë, kurse në deklaratën e pasurisë së procesit të rivlerësimit kalimtar - vetting, subjekti ka deklaruar shpenzime totale në vlerën 9.1 milionë lekë.
- Komisioni vlerëson se kjo mospërputhje nuk krijon dyshime për fshehje të pasurisë dhe se deklarata e procesit të rivlerësimit kalimtar është e saktë dhe përputhet me realitetin. Nga aktet rezulton se vlera 5.8 milionë lekë është shpenzuar nga bashkësia ligjore për ndërtimin e sipërfaqes së katit të banimit; vlera 4.1 milionë lekë është shpenzuar nga bashkësia ligjore për ndërtimin e pjesës takuese ¼ në bashkëpronësi e katit të parë të njësisë shërbim; vlera 800 mijë lekë është shpenzuar nga bashkësia ligjore për ndërtimin e pjesës respektive të bashkëpronësisë në bodrumin e objektit pesëkatësh; vlera 400 mijë është shpenzuar nga bashkësia ligjore për ndërtimin e njësisë së shërbimit që ka funksionuar si zyrë dhe vlera 1.6 milion lekë është shpenzuar nga bashkësia ligjore për arredimin e njësisë së banimit të subjektit të rivlerësimit. Nga këta zëra shpenzimesh, rezulton se vlera e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për llogari të procesit të rivlerësimit, - konkretisht vlera 9.1 milionë lekë, -përputhet dhe justifikohet si shumatore e shpenzimeve të kryera nga bashkësia ligjore.
- Lidhur me apartamentin e shitur në vitin 1999, në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij, që ka shërbyer si një nga burimet kryesore të të ardhurave për ndërtimin e godinës (*pjesa e subjektit*), sipas ZVRPP-së Tiranë rezulton se është ende në pronësi të subjektit. ILDKPKI-ja është shprehur se, rezulton që ky shtetas (*blerësi*) nuk ka kryer procedurën e regjistrimit të apartamentit në emër të tij, por nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.
- Bazuar në nenin 196 të Kodit Civil, nuk është detyrim i shitësit regjistrimi i pronës në ZRPP, por detyrim i blerësit. Në rastin konkret, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti (*shitësi*) për një veprim që duhet ta kishte kryer blerësi. Ky arsyetim mbështetet edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1, datë 06.01.2009. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në momentin e plotësimit të Deklaratës-Vetting,

nuk ka pasur asnjë të drejtë pasurore që lidhej me këtë send dhe, për rrjedhojë, as edhe detyrim ligjor për ta deklaruar.

- Nga hetimi administrativ i Komisionit janë konstatuar ndryshime në deklaratimet e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ndër vite në raport me deklaratimet e bëra në Deklaratën-Vetting. Këto ndryshime nuk vlerësohen të jenë thelbësore dhe në atë masë që të arrihet në përfundimin se jemi para një shkakut kushtetues për dhënien e masës së shkarkimit. Ndryshimet kanë të bëjnë me vlerën e kostos për ndërtimin e sendit të ri të zhvilluar urbanisht apo me disa metra katrorë të sipërfaqes së apartamentit dhe njësisë të shërbimit në bashkëpronësi. Ajo çka është konkluduar dhe provuar gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit është se, pavarësisht ndryshimeve të deklaratave të pasurisë ndër vite me deklaratën e pasurisë të realizuar për llogari të procesit të rivlerësimit kalimtar, informacionet e deklaruara vullnetarisht mbi vlerën e pasurisë likuiditet dhe atë të transformuar në pasuri të paluajtshme dhe informacionet mbi sipërfaqet e pronave njësi banimi dhe shërbimi të deklaruara vullnetarisht nga subjekti i rivlerësimit përputhen me konkluzionet e Komisionit gjatë hetimit dhe me atë që realisht është gjendja juridike dhe faktike e këtyre pasurive.
- Komisioni vlerëson se kompetenca, me të cilën Kushtetuta dhe ligji e kanë ngarkuar këtë organ për të ushtruar procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të kufizohet dhe të jetë vetëm gjetja e gabimeve ndër vite të subjekteve që hetohen dhe gjykohen. Përkundrazi, Komisioni gjatë hulumtimit dhe zbatimit të detyrave funksionale duhet që këto pasaktësi t'i shoqërojë me konkluzionin se janë pikërisht ato mjetet me të cilat subjekti i rivlerësimit fsheh pasurinë apo burimin e krijimit të saj. Fokusi kryesor juridiksional i Komisionit është dhe mbetet përgjatë gjithë procesi saktësia dhe vërtetësia e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë të realizuar në kuadrin e procesit të rivlerësimit kalimtar. Sigurisht që mospërputhjet me deklaratat ndër vite janë indice për të nisur hetimin dhe për të hulumtuar më tej në konkluzione nëse ka shkelje të Kushtetutës dhe ligjit apo jo nga subjekti i hetuar dhe gjykuar. Kjo do të thotë se, nëse pasaktësia apo mospërputhja është e palidhur me fshehjen e pasurisë dhe është pasojë e një konteksti të caktuar të perceptimit të gabuar dhe në mirëbesim të subjektit të rivlerësimit, atëherë kjo rrethanë nuk mundet kurrsesi të kualifikohet si një nga rastet e legjitimuara nga Kushtetuta për dhënien e një mase disiplinore nga ana e organeve vendimmarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar.
- Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni vlerëson se mospërputhjet e deklaratimeve ndër vite të subjektit nuk provojnë dhe as të çojnë në konkluzionin se ai ka fshehur pasurinë dhe se, nga ana tjetër, subjekti ka përmbushur barrën e provës për të provuar ligjshmërinë e aseteve pasuri të paluajtshme të krijuara gjatë detyrës. Në këtë arsyetim, Komisioni merr parasysh edhe faktin se ky aset është krijuar nga subjekti përpara se të merrte detyrën e gjyqtarit, pra jashtë periudhës së rivlerësimit.
- Për sa u përket kontratave të shitjes, të hartuara nga noteri ndërmjet subjekteve bashkëpronarë në vitin 2001, Komisioni vlerëson se nuk janë ato mjetet apo mënyrat ligjore se si është konstituuar marrëdhënia e pronësisë mbi objektin pesëkatësh të ndërtuar mbi truallin e njohur dhe kthyer nga organet e kthimit të pronave. Mënyra e fitimit të

pronësisë është bashkimi dhe përzierja, sikurse parashikohet dhe rregullohet në nenin 173 e vijues të Kodit Civil. Për rrjedhojë, edhe pronësia e sendit apo e pjesëve njësi banimi dhe shërbimi kundrejt bashkëpronarëve është konstituuar në momentin kur sendi është formësuar, që do të thotë që në muajin gusht të vitit 1997. Në pamje të parë të krijohet përshtypja se kontratat e shitjes së vitit 2001 janë fiktive, në bazë të nenit 92/ç të Kodit Civil, pasi janë kryer nga palët vetëm me qëllimin që të realizohej formalisht regjistrimi i pasurive të paluajtshme në regjistrin publik. Duke analizuar faktet, rezulton se subjekti ka investuar në ndërtimin e asetit mbi truallin në pronësi të gjyshit dhe hallës së bashkëshortes. Duke mos u regjistruar zyrtarisht si investitor, si dhe për të fituar ligjërisht pronësinë mbi pjesën e pasurisë që i takonte, ai ka lidhur këto kontrata, që mund të konsiderohen si fiktive, por që nuk kanë si qëllim mashtrimin. Komisioni vlerëson se veprimet juridike fiktive nuk mundet të interpretohen apo të kualifikohen si shkaqe penaliteti disiplinor për palët që i kryejnë, nëse këto veprime nuk shoqërohen me kundërvajtje administrative apo fakte që përbejnë vepra penale. Përkundrazi, simulimi i kontratës apo veprimit juridik, qoftë relativ apo absolut, kur nuk shoqërohet me shkeljet e një natyre tjetër ligji, sikurse u përmend më lart, përbën një paligjshmëri civile dhe se për to Kodi Civil parashikon, sipas parimit kushtetues të proporcionalitetit (*shiko nenin 17 të Kushtetutës*), sanksione me natyrë juridike civile.

- Në këto kushte, Komisioni çmon se fiktiviteti në dukje i kontratave të lidhura me familjarët e bashkëshortes, nuk ka pasur qëllim mashtrimin apo fshehjen e fakteve, ngjarjeve apo pasurisë. Subjekti ka shfrytëzuar hapësirat ligjore në favor të interesave të tij. Duke ripërsëritur faktin se këto veprime janë kryer jashtë periudhës së rivlerësimit, Komisioni arsyeton se nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që çojnë në shkarkimin e subjektit nga detyra.

19. Njësi shërbimi (dyqan) me sipërfaqe 70 m², me certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.04.2015, në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten, në të njëjtën godinë me apartamentin më sipër. Vlera e deklaruar 1.400.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat personale dhe të ardhurat nga qiraja.

19.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.

19.2 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Në lidhje me këtë pasuri, ZVRPP Tiranë ka konfirmuar pronësinë e subjektit dhe bashkëshortes së tij mbi pasurinë me sip. 70 m², ZK ***, nr. pasurie ***, Rr. “****”, shk. ***, ap. *** Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 31.08.2017 dhe nr. *** prot., datë 28.09.2017.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit për pasurinë e paluajtshme dyqan, me sip.70 m² (*Deklarata-Vetting, viti 2017*) bie në kundërshtim me deklarimin e parë të bërë për vitin 2003 dhe kontratën përkatëse të shitblerjes (*kontrata e vitit 2001*) për këtë pasuri. Sipas Deklaratës-Vetting, vlera e

dyqanit e deklaruar është 1.8 milion lekë, kurse sipas deklarimit për herë të parë është deklaruar bibliotekë me vlerë 1.4 milion lekë dhe kontrata e shitblerjes pranë noterit është në vlerën 500.000 lekë.

Njëlloj si në arsyetimin e mësipërm për apartamentin në të njëjtën godinë, Komisioni çmon se, pavarësisht se vlera reale e njësisë së shërbimit nuk është ajo e parashikuar në kontratën e shitblerjes, arsyeja e kësaj kontrate është shmangia nga tatimi. Në kushtet e mungesës së detyrimit ligjor për çmimin e referencës, subjekti nuk mund të fajësohet për faktin se ka qenë në gjendje të shfrytëzojë boshllëqet ligjore në favor të tij.

Subjekti për këtë pasuri ka dhënë shpjegime si për pasurinë e mësipërme, duke qenë se ato janë në të njëjtën godinë dhe se kjo njësi shërbimi (*dyqan*), me sipërfaqe 70 m², është pjesë integrale e pasurisë së krijuar nga zhvillimi urban i pronës tokë truall, e njohur dhe kthyer fizikisht nga organet kompetente të kthimit dhe kompensimit të pronave.

19.3 Arsyetimi ligjor

- Ka rezultuar se dyqani është pjesë përbërëse e objektit të ndërtuar me bashkëkontribut ndërmjet bashkësisë ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe tri familjeve të tjera që jetojnë aty. Kjo do të thotë se i gjithë arsyetimi dhe gjetjet e bëra më lart mbi origjinën e pronësisë së truallit, zhvillimit urban të saj, mënyrën e fitimit të pronësisë, gjendjen juridike të bashkëpronësisë, veprimet konkludente dhe marrëveshjet ndërmjet bashkëpronarëve familjarë, momentin e fitimit të pronësisë dhe regjimi juridik i objektit, duke qenë se zyra me sipërfaqe 70 m² është pjesë integrale e objektit, vlejnë si konkluzione dhe gjetje edhe për këtë pasuri të paluajtshme (*shiko argumentet më lart*).
- Sipërfaqet e sakta për secilën nga pronat, ashtu sikurse edhe subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjatë mbrojtjes, rezultojnë të jenë të sakta sipas atyre madhësive dhe sipërfaqeve që pasqyrohen në aktet e pronësisë së lëshuar nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (*viti 2015*) dhe që përkojnë saktësisht me ato që subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar dhe deklaruar në Deklaratën-Vetting;
- Rezulton se mospërputhjet në sipërfaqe janë të vogla dhe kanë ardhur nga mungesa e matjeve profesionale dhe zyrtare. Nga matjet reale të pronës është nxjerrë konkluzioni se sipërfaqja e dyqanit apo bibliotekës është 70 m², bodrumi është 65 m² dhe zyra është 15 m² (*shih sqarimin e pikës 1 për çështjen se pse quhet kjo njësi shërbimi herë si bibliotekë dhe herë si dyqan*).
- Edhe vlerat e kostos së ndërtimit të këtyre tri hapësirave, si pjesë e pandarë e objektit, rezultojnë të jenë të sakta dhe përpunohen me përmbajtjen e Deklaratës-Vetting, pasi 1.4 milion lekë rezulton të jetë kostoja e ndërtimit për metër katror të bibliotekës dhe tashmë dyqanit; 800 mijë lekë rezulton të jetë kostoja e ndërtimit të bodrumit; dhe 400 mijë lekë rezulton të jetë kostoja e ndërtimit të zyrës. Gjithnjë duke pasur parasysh kontributin respektiv në ¼-ën pjesë të kontributit të përgjithshëm, që ka mundësuar ndërtimin e sendit objekt pesëkatësh. Mospërputhja e Deklaratës-Vetting me deklaratën e vitit 2003 është shkaktuar nga fati se në 2003-shin janë përfshirë edhe kostot e arredimit, duke qenë se sendet ishin bërë gati për t'u dhënë me qira te të tretët.

- Këto tri hapësira të njërive të shërbimit nuk rezultojnë të jenë ndarë juridikisht dhe fizikisht ndërmjet bashkëpronarëve dhe se nuk ka kufij fizikë të brendshëm në këto njësi shërbimi. Kjo rezultojnë të jetë lënë qëllimisht në këtë gjendje, në mënyrë që të maksimalizohet aspekti funksional i pronës dhe përfitimi nga zhvillimi i aktivitetit ekonomik në to.
- Qiratë nga njësitë e shërbimit të përfituara ndër vite janë ndarë në katër pjesë, ¼-ta për secilën familje, sipas marrëveshjes që ka ekzistuar në mënyrë permanente ndërmjet bashkëpronarëve për qarkullimin civil të pronës dhe shfrytëzimin ekonomik të saj.
- Duke sjellë në vëmendje sqarimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të dhënë më lart, konkretisht në pikën 18.2 të arsyetimit ligjor, dhe duke pasur parasysh se edhe kjo pronë, pasuri e paluajtshme, ndodhet si pjesë integrale e sendit të përgjithshëm të zhvilluar urbanisht dhe të krijuar me bashkim dhe me përzjerje, - konkludohet se mospërputhjet dhe pasaktësitë e deklarimeve ndër vite ndërmjet deklaratave të pasurisë së zakonshme dhe deklaratës së pasurisë të realizuar për llogari të procesit të rivlerësimit kalimtar, nuk përbëjnë rrethana të tilla kushtetuese që të arrihet në përfundimin se ka fshehje të pasurisë dhe, për rrjedhojë, nuk mundet të legjitimohet aplikimi i masave disiplinore.
- I njëjti konkluzion si më lart (*shiko pikën 18.2 të arsyetimit ligjor*) vlen edhe për vlefshmërinë e veprimit juridik të kontratës së shitjes së vitit 2001 dhe faktit nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur apo jo si qëllim për të shmangur detyrimet fiskale nga fiktiviteti i kontratës apo i çmimit të deklaruar.
- Sipërfaqja e katit të parë, njësi shërbimi, rezultojnë të jetë 281 m², nga ku idealisht secila familje bashkëpronare ka nga 70 m²; sipërfaqja e bodrumit rezultojnë të jetë 260 m², nga ku idealisht secila familje bashkëpronare ka nga 65 m²; sipërfaqja e zyrës rezultojnë të jetë 60 m², nga ku idealisht secila familje bashkëpronare ka 15 m².
- Kontratat e qirasë nuk rezultojnë të jenë hartuar me akt noterial, pasi në momentin e hartimit të tyre nuk ka pasur asnjë normë ligjore apo nënligjore që të detyronte palët kontraktore në një marrëdhënie juridike qiraje për ta veshur me këtë formë veprimin juridik.
- Sikurse në mënyrë më të detajuar jepet më poshtë këtij vendimi, konkretisht në pjesën që analizohet ligjshmëria e së ardhurës nga qiraja ndër vite, rezultojnë se përfaqësuesja e bashkëpronarëve në marrëdhënien juridike të qirasë me të tretët ka qenë znj. M. H. Ajo marrte pagesat dhe ajo shpërndante sipas pjesëve pagesat respektive. Më vonë, para rreth gjashtë viteve, bashkëpronarët kanë përcaktuar si përfaqësuese në marrëdhënien juridike të qirasë bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, znj. N. Z., llogaria e së cilës në “Raifeissen Bank” sh.a. kreditohej dhe më pas ajo ia kalonte vlerat sipas pjesëve takuese secilit bashkëpronar.

20. Bodrum, me sip. 65 m², në bashkëpronësi, në të njëjtin pallat me apartamentin me certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.04.2015 (bodrum me sipërfaqe totale 260 m² në bashkëpronësi të 8 pronarëve, pjesa takuese 2/8). Vlera e shitjes sipas deklaramit: 800.000 lekë. Krijuar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë. ZVRPP ka konfirmuar pronësinë dhe vlerën e shitjes, sipas kontratës përkatëse prej 500.000 lekësh.

20.1 Për këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.

20.2 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

ZVRPP Tiranë ka konfirmuar pasurinë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit ndodhur në ZK ***, nr. pasurie ***, Rr. “****”, shk. ***, ap. ***, Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 31.08.2017, dhe nr. *** prot., datë 28.09.2017.

Subjekti ka deklaruar një sipërfaqe bodrum 65 m², në bashkëpronësi, në të njëjtin pallat me apartamentin me certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.04.2015 (bodrum me sipërfaqe totale 260 m² në bashkëpronësi të 8 pronarëve, pjesa takuese 2/8). Vlera e shitjes sipas deklarimit në Deklaratën-Vetting është 800.000 lekë. Burimi i krijimit është deklaruar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë së krijuar. ZVRPP ka konfirmuar pronësinë dhe vlerën e shitjes sipas kontratës përkatëse të hartuar pranë noterit prej 500.000 lekësh.

Deklarimi si subjekt rivlerësimi për pasurinë e paluajtshme bodrum me sip. 65 m² (*Deklarata-Vetting, viti 2017*) bie në kundërshtim me deklarimin e parë të bërë për vitin 2003 dhe kontratën përkatëse të shitblerjes (*kontrata e vitit 2001*) për këtë pasuri. Sipas Deklaratës-Vetting, vlera e bodrumit e deklaruar është 800.000 lekë, sipas deklarimit për herë të parë është deklaruar bodrum + zyrë me vlerë 1.5 milion lekë, me sipërfaqe 90 m², dhe kontrata e shitblerjes është në vlerën 500.000 lekë.

Në një vlerësim paraprak rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklarime të ndryshme dhe rezulton që edhe kontrata nuk korrespondon me deklarimet për pasuritë e blera, si për vlerën, edhe për sipërfaqen.

20.3 Arsyetimi ligjor

- Ka rezultuar se bodrumi është pjesë përbërëse e objektit të ndërtuar me bashkëkontribut ndërmjet bashkësisë ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe tri familjeve të tjera që jetojnë aty. Kjo do të thotë se i gjithë arsyetimi dhe gjetjet e bëra më lart mbi origjinën e pronësisë së truallit, zhvillimin urban të saj, mënyrën e fitimit të pronësisë, gjendjen juridike të bashkëpronësisë, veprimet konkludente dhe marrëveshjet ndërmjet bashkëpronarëve familjarë, momentin e fitimit të pronësisë dhe regjimi juridik i objektit, - duke qenë se bodrumi me sipërfaqe 70 m² është pjesë integrale e objektit, - vlejnë si konkluzione dhe gjetje edhe për këtë pasuri të paluajtshme (*shiko argumentet më lart*).
- Pasaktësitë në deklarimin ndër vite të subjektit nuk të çojnë në lindjen e dyshimeve për fshehje të pasurisë apo të ardhurave.

21. Zyrë me sip. 15 m², në bashkëpronësi me bashkëshorten 50 %, me certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.04.2015. Vlera: 400.000 lekë. Krijuar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë. ZVRPP-ja ka konfirmuar pronësinë dhe vlerën e shitjes prej 500.000 lekësh.

21.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.

21.2 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Subjekti ka deklaruar zyrë me sipërfaqe 15 m² në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten, me certifikatë pronësie nr. ***, datë 16.04.2015. Vlera: 400.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë. ZVRPP Tiranë ka konfirmuar pronësinë dhe vlerën e shitjes pranë noterit prej 500.000 lekësh.

ZVRPP Tiranë ka konfirmuar pasurinë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit ndodhur në ZK *** nr. pasurie ***, Rr. “****”, shk. ***, ap. ***, Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 31.08.2017, dhe nr. *** prot., datë 28.09.2017.

21.3 Arsyetimi ligjor

- Edhe kjo pasuri ndodhet në të njëjtën godinë me tri pasuritë e sipërpërmendura. Në analizë të saj, arrihet në konkluzionin se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklarimet ndër vite, por nuk mund të arsyetohet në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, duke qenë se nuk ka asnjë dyshim për fshehje të pasurisë apo të të ardhurave.

22. Apartament, me sip. 81 m²; me adresë: ap. ***, kat. ***, Lagjja ***, Plazh, Durrës. Në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten, pjesë e bashkësisë ligjore, ndërtuar në vitin 2006 dhe e blerë me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.06.2006, me çmim 32.000 USD. Pasuri e krijuar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë. Shitja dhe vlera është konfirmuar nga ZVRPP.

22.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.

22.2 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Subjekti ka deklaruar blerjen e një apartamenti me sip. 81 m² në Lagjen nr. ***, Plazh, në qytetin e Durrësit, ap. ***, kati ***, në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten dhe pjesë e bashkësisë ligjore. Kjo pasuri është ndërtuar në vitin 2006 dhe blerë me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.06.2006, nga subjekti i rivlerësimit. Vlera e çmimit të blerjes është 32.000 USD dhe rezulton të jetë krijuar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e përfituara nga njësia e shërbimit në bashkëpronësi, e sqaruar më lart, dhe e lëshuar ndër vite me kontratë qiraje. Shitja dhe vlera është konfirmuar nga ZVRPP-ja.

ZVRPP Durrës ka konfirmuar pasurinë në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes me sip. 81 m², ZK ***, nr. pasurie ***, Lagjja ***, Plazh, shk. ***, ap. ***, Durrës, me shkresën nr. ***, datë 9.10.2017.

Pas verifikimit, rezultuan se të dhënat e deklaruara nga subjekti ishin të sakta lidhur me pasurinë në fjalë, kontratën e lidhur, vlerën, sipërfaqen, e konfirmuar kjo dhe nga ZVRPP-ja Durrës.

Lidhur me burimin e krijimit të vlerës financiare për blerjen e kësaj pasurie, iu kërkua subjektit të deklaronte dhe vërtetonte veprimet përkatëse.

Subjekti i është përgjigjur kërkesës se pjesa më e madhe e shumës prej rreth 16.000 USD është tërhequr nga depozita e përbashkët me bashkëshorten në bankën “Intesa Sanpaolo” sh.a., si dhe tërheqja dhe mbyllja e llogarisë në shumën prej 1.25 milionë lekësh.

Sipas shkresës së bankës “Intesa Sanpaolo” rezulton se subjekti ka pasur në llogari bankare vlerën prej rreth 16.000 USD, por që nuk rezulton të ketë kryer veprime për tërheqjen e kësaj vlere dhe kryerjen e pagesës ndaj shoqërisë shitëse të pasurisë së paluajtshme.

22.3 Arsyetimi ligjor

- Sipas subjektit, burimi i krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme ka qenë qiraja mujore e përfituar çdo muaj nga “****” dhe kursimet, kryesisht nga kjo e ardhur ndër muaj. Nga përlllogaritjet del se nga janari i vitit 1999, periudhë kur subjekti i rivlerësimit bashkë me bashkëshorten kanë nisur të përfitojnë si pjesë e bashkësisë ligjore të ardhurën nga qiraja, e deri në fundin e vitit 2002, të jetë përfituar shuma prej 38.400 USD. Pjesa prej 16.000 USD janë pikërisht kursimet nga kjo e ardhur dhe pjesa tjetër normalisht është përdorur për të përballuar shpenzimet e ndryshme familjare.
- Rezulton se në vitet 2003 - 2005 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. totalin e shumës 47.000 USD dhe se nga kjo shumë janë përfituar interesa në vlerën 3.000 USD. Pikërisht nga kjo shumë, në këtë bankë është tërhequr shuma prej 34.000 USD, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në qytetin e Durrësit. Këto fakte dalin nga këqyrja e deklaratave të pasurisë, të depozituara ndër vite, nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI.
- Kjo do të thotë se subjekti i rivlerësimit ndër vite ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të legjitimuar pasurinë burim të mënyrës se si është fituar pasuria e paluajtshme në qytetin e Durrësit.

23. Pagesë e kryer në dhjetor të vitit 2008 ndaj shoqërisë “****”, në bashkëpronësi 50 %. Vlera e deklaruar 35.000 USD + 1.200.000 Lekë. Burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë mujore të njëjësive të shërbimit, e përfituar në ¼-ën pjesë.

23.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja nuk është shprehur nëse përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e institucioneve.

23.2 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Subjekti ka deklaruar se ka kryer pagesë në muajin dhjetor të vitit 2008 ndaj shoqërisë “****”, në bashkëpronësi 50 %. Vlera e deklaruar 35.000.000 USD + 1.200.000 lekë. Krijuar nga të ardhurat personale dhe të ardhurat e qirasë. Ky veprim nuk është konfirmuar nga ZVRPP-ja Shkodër. Nuk ka rezultuar nëse ka pasur një kontratë shitblerjeje apo kontratë tjetër, sipas mënyrave që parashikon Kodi Civil për këtë veprim juridik.

Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se apartamenti nuk është ndërtuar përfundimisht, si rrjedhojë nuk është i regjistruar në ZVRPP. Në deklaratën e vitit 2008, subjekti ka tërhequr depozitën në shumën 34 mijë USD, konfirmuar nga banka “Intesa Sanpaolo”.

Sipas deklarimit të bërë pranë ILDKPKI-së, subjekti ka theksuar se pagesa për këtë shoqëri nuk është bërë me qëllim fitimi apo përfshirjen në sipërmarrje, por me këtë shoqëri ka lidhur marrëveshje për blerjen e një ambienti, në përfundim të ndërtimit të pallatit. Gjithashtu, sipas pyetësorit të plotësuar nga subjekti, rezulton se për përballimin e shpenzimeve për rinovimin e shtëpisë të ardhurat (*pjesa më e madhe*) janë përballuar nga shuma prej 1.000.000 lekësh, që ka marrë nga shoqëria “****”, si pjesë e shumës që ka investuar (*dhënë*) në këtë shoqëri në vitin 2008.

Lidhur me këtë pasuri, iu kërkua nga Komisioni subjektit të deklaronte veprimin juridik të kryer sipas ligjit, si më poshtë:

Subjekti ka deklaruar se veprimi për këtë pasuri nuk është investim, por shpenzime të kryera për blerje pasurie. Ai nuk ka paraqitur kontratë të lidhur sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për fitim pronësie të paluajtshme.

Rezultojnë se veprimet e kryera për blerjen e pasurisë së paluajtshme nuk janë bërë nga subjekti në përputhje me legjislacionin në fuqi (*Kodin Civil*), si dhe praktikën gjyqësore, siç është vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 6.1.2009, për fitimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme.

Në mbështetje të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i është ngarkuar barra e provës për të paraqitur prova lidhur me deklarinimet e bëra, kontratën e lidhur sipas legjislacionit shqiptar për blerje pasurie të paluajtshme, pagimin e vlerës së blerjes së pasurisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, shoqëruar me dokumentacionin ligjor përkatës.

23.3 Arsyetimi ligjor

- Nga hetimi administrativ konstatohet se në vitin 2008 subjekti i deklarimit ka tërhequr nga llogaria bankare në “Intesa Sanpaolo” shumën 34.000 USD dhe ka shtuar shumën 1.000 USD dhe, nga këto të ardhura është paguar shuma respektive për blerjen e një apartamenti të ardhshëm te shoqëria “****” sh.p.k., në pallatin që po ndërtonin në qytetin e Shkodrës.
- Subjekti i rivlerësimit dhe dy vëllezërit, ortakë të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., rezulton të kenë qenë miq të afërt në Shkodër, që nga koha e gjimnazit në vitet 1970 dhe

se kanë prej dekadash miqësi familjare. Te po e njëjta shoqëri, rezultojnë të jetë blerë në vitin 2006 edhe apartamenti në qytetin e Durrësit nga subjekti i rivlerësimit.

- Nga këto marrëdhënie të ngushta miqësie shpjegohet mirëbesimi i palëve në këtë transaksion dhe veprim juridik dhe mungesa e formalizimit të marrëdhënies juridike në kontratë.
- Transaksioni i kryer, nga të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ në procesin e rivlerësimit kalimtar, rezultojnë të jetë një veprim juridik me veprime konkludente dhe me marrëveshje verbale, e llojit kontratë shitjeje dhe blerjeje e një sendi të ardhshëm, nga ku blerësi i ardhshëm, z. Xhezair Zaganjori, paguante për llogari të shitësit të ardhshëm, “***” sh.p.k., vlerën si më lart, për blerjen e një apartamenti në momentin kur pallati do të përfundonte së ndërtuari.
- Nga të gjitha rrethanat arrihet në konkluzionin se fjala “*investim*”, e përdorur në mandatpagesën për shumën çmim të sendit të ardhshëm, nuk mundet të jetë kontribut ekonomik për krijimin e një shoqërie të thjeshtë, sipas parashikimeve të Kodit Civil, dhe nuk mundet të jetë as veprim juridik për tjetërsim kuotash apo aksionesh, por është një fjalë e papërshtatshme, vendosur ndoshta jashtë kontekstit të logjikës së veprimit juridik, për të cilin palët ishin dakordësuar. Duhet të theksohet se fjala “*intestim*” rezultoi të ketë qenë edhe praktika e realizimit të transaksioneve ndërmjet firmës së ndërtimit dhe klientëve të saj gjatë kohës që ky pallat po ndërtohej.
- Komisioni mban parasysh se fatura e arkëtimit të shumës çmim të paguar nga subjekti i rivlerësimit të shoqëria e ndërtimit, sipas nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, përbën një shkresë private, që vërteton kryerjen e një transaksioni ndërmjet palëve të ardhshme kontraktore të kontratës së shitjes së një apartamenti dhe se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar tek organet kompetente në kuadër të deklaratimit të pasurive periodikisht. Burimi i krijimit të kësaj shume rezultojnë të kenë qenë tërheqjet nga dy llogari bankare të bashkësisë ligjore, respektivisht shumat 34.000 USD dhe 1.200.000 lekë. Pikërisht në të njëjtën ditë provohet të ketë ndodhur edhe tërheqja e parave nga banka, edhe kryerja e transaksionit të materializuar në mandatin e arkëtimit me shoqërinë e ndërtimit.
- Komisioni vlerëson se kjo marrëdhënie materialisht përbën fillimin e një kontrate, duke qenë se objekt transaksioni ka një send të ardhshëm, që përbën pasuri të paluajtshme, sipas nenit 83 të Kodit Civil, dhe se për të qenë veprim juridik i vlefshëm duhet të bëhet me shkrim dhe të vishej me akt noterial. Megjithatë, Komisioni vlerëson se, nga mospërpilimi sipas formës së kërkuar nga ligji nuk mundet të konkludohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit është shkelur ligji. Përkundrazi, formën noteriale të veprimeve juridike që tjetërsojnë pasuri të paluajtshme ligji civil material e kërkon si kusht për vlefshmërinë (*ad validitatem*) dhe provueshmërinë (*ad probationem*) e një veprimi juridik, që do të thotë se mosrespektimi i formës e bën veprimin juridik absolutisht nul dhe se nuk mundet të përdoret prova me dëshmitar për të provuar ekzistencën e tij. Kjo do të thotë se marrëveshja e arritur ndërmjet palëve më shumë ishte një dakordësi miqsh, sikurse kishte ndodhur edhe më parë për shtëpinë e blerë në Durrës, dhe se në momentin kur sendi i ardhshëm do të formësohej, atëherë do të arrihej edhe formësimi i kontratës noteriale të shitjes, me qëllim që të mundësohej edhe regjistrimi i pasurisë.

- Komisioni mban parasysh se subjekti i rivlerësimit për këtë çështje është ftuar të japë sqarime edhe më parë nga ILDKPKI-ja në vitin 2010 dhe se sqarimi i tij atëherë rezultoi të jetë i njëjtë me sqarimin që ka bërë para autoriteteve kushtetuese të procesit të rivlerësimit kalimtar.
- Në këto rrethana, Komisioni vlerëson se qëllimi i formësimit të mandatpagesës ka qenë krijimi i një prove shkresore private nga palët kontraktore, që vërtetonte kryerjen e një transaksioni apo pagese në një shumë të konsiderueshme, që të dokumentonte këtë fakt. Për rrjedhojë, Komisioni nuk kufizohet në vlerësim tek emërtimi nominal, por vlerëson të vërtetën materiale në zhvillimin e dinamikës së marrëdhënies juridike dhe faktike të shtrirë në kohë të palëve, duke pasur parasysh edhe parashikimin ligjor të nenit 681 të Kodit Civil mbi interpretimin ligjor të kontratave.
- Rezultoni se apartamenti nuk u arriti të ndërtohej dhe se palët, sërish verbalisht, kanë rënë dakord që të kthejnë shumën e çmimit të blerjes së sendit të ardhshëm dhe të zgjidhet edhe kontrata, në mënyrën që ishin dakordësuar. Aktualisht, shoqëria ka shlyer shumën prej 1 milion lekësh.
- Nuk rezultoi asnjë dyshim për origjinën dhe burimin e krijimit të pasurisë dhe likuiditeteve që kanë shërbyer për të kryer këtë pagesë. Në këtë konkluzion arrihet natyrshëm, kur mban parasysh të ardhura nga qiraja dhe kursimet mujore që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij arrijnë të realizojnë. Analiza e raportit ndërmjet të ardhurave të hyra dhe atyre që njihen si shpenzime janë të tilla që nuk krijojnë dyshime mbi pasurinë e krijuar për efekt të realizimit të transaksionit.

24. Obligacione me vlerë 6.1 milion lekë në “Raiffeisen Bank” sh.a., me zotërim 100 %.

24.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*konfirmuar nga banka me shkresën nr. ***, datë 28.06.2017*).

24.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

25. Llogari rrjedhëse në vlerën 108.654 euro në “Raiffeisen Bank” sh.a., konfirmuar nga banka me shkresën nr. *, datë 28.06.2017. Zotërim 100 %.**

25.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës.

25.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

26. Llogari rrjedhëse 382.173 lekë në “Raiffeisen Bank” sh.a., konfirmuar nga banka me shkresën nr. *, datë 28.06.2017. Zotërim 100 %.**

26.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës:

26.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

27. Llogari rrjedhëse me vlerë 164.607 lekë në “Raiffeisen Bank” sh. a., konfirmuar nga banka me shkresën nr. ***, datë 28.06.2017. Zotërim 100 %.

27.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës.

27.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

28. Depozitë bankare 6.510.143 lekë në “Intesa Sanpaolo” sh.a., e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

28.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës.

28.2 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. *** prot..., datë 03.07.2017, konfirmon dhe llogari rrjedhëse në emër të subjektit me gjendje 2 USD dhe llogari e përbashkët me bashkëshorten me gjendje 11 USD.

28.3 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk janë konstatuar parregullsi.

29. Depozitë 14.890 euro në “Intesa Sanpaolo” sh.a., e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

29.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 03.07.2017*).

29.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

30. Gjendje e kartës personale “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. 7.924 lekë dhe karta e punës 27.449 lekë.

30.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 3.7.2017*).

30.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

31. Llogari bankare 799.69 lekë në “Raiffeisen”.

31.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017*).

31.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

32. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” sh.a. 390.932 lekë, gjendja datë 22.12.2016.

32.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se: “Rezultoni mospërputhje midis deklaramit dhe përgjigjes së bankës, e cila vjen si rezultat i datave të ndryshme të marrjes së rezultatit (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017, konfirmon llogari page në shumën 468.606 lekë në datë 30.01.2017*)”.

32.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

33. Llogari kursimi “Raiffeisen Bank” sh.a. në vlerën 367.87 lekë.

33.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017*).

33.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

34. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” sh.a. në vlerën 13.996 euro.

34.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017*).

34.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

35. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” sh.a. 1.41 paund.

35.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017*).

35.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

36. Llogari bankare në “Deutsche Bank”, Mynih, Gjermani, në vlerën 11.160 euro. Të ardhura nga prindërit.

36.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës.

36.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

37. Llogari bankare në “Sparkasse Bank”, Mynih, Gjermani, 1.430 euro, të ardhura nga të afërmit.

37.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës.

37.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

38. Gjendje në vlerën 515.000 lekë në “Raiffeisen Bank” sh.a., të ardhura nga të afërmit.

38.1 Për këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konkluduar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e bankës (*shkresa nr. *** prot., datë 28.06.2017*).

38.2 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar parregullsi.

39. Me qëllim verifikimin e deklaratave të subjektit, vërtetimin e të ardhura të ligjshme, shpenzimeve të kryera dhe likuiditeteve, është përgatitur analiza financiare për pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur. Kjo analizë financiare është bazuar në të ardhurat nga burimet e ligjshme të vërtetuara nga informacioni i mbledhur në rrugë zyrtare nga Komisioni, gjatë fazës së hetimit administrativ, ku kanë rezultuar:

Nga shqyrtimi i të ardhurave ndër vite të subjektit të rivlerësimit rezultoi se të ardhurat e çdo viti të bashkësisë ligjore, nga burime të ndryshme dhe të marra si shumatore e përgjithshme, rezultojnë ndjeshëm më të mëdha sesa shpenzimet dhe se në këtë mënyrë, në çdo vit, bashkësia ligjore ka pasur bilanc pozitiv, çka justifikon vlerat e kursyera në llogari bankare ndër vite apo me të cilat janë kryer transaksionet për pasuri të paluajtshme apo shkollimin e fëmijëve. Ky konkluzion del nga aritmetika e të hyrave dhe shpenzimeve të deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe nga deklaratimet e çdo të ardhure të fituar ndër vite nga puna e ligjshme apo nga marrëdhëniet kontraktore të ligjshme.

Më konkretisht dhe të detajuara jepen si më poshtë:

- Subjekti i rivlerësimit ka nisur punë si pedagog i së drejtës ndërkombëtare në vitin 1980 dhe ka punuar në Fakultetin e Drejtësisë deri në vitin 1992;
- Në vitin 1986 familjarisht kanë shitur shtëpinë private në Shkodër dhe kanë nisur të banojnë në apartamentin e tij në Tiranë;
- Në vitin 1988 ka qenë për dy muaj për kërkim shkencor në institutin “****” në Heidelberg të Gjermanisë dhe ka përfituar një bursë rreth 8.000 marka;
- Në fillim të prillit 1991 deri në fundin e qershorit 1991 ka kryer një kërkim shkencor për tre muaj në Gjermani, në institutin “****”, duke përfituar shumën e bursës së studimit rreth 9.000 marka;

- Subjekti i rivlerësimit është aktivizuar si këshilltar gjatë vitit 1991 dhe 1992 i studiove të avokatisë dhe shoqërive të huaja që operonin në atë kohë në Shqipëri, duke krijuar të ardhura veç punës si pedagog;
- Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar nga viti 1989 deri 1992 si mësuese e lëndës së Historisë në gjimnazin “Partizani”, Tiranë;
- Nga gushti i vitit 1992 e deri në tetor 1997 subjekti i rivlerësimit ka kryer detyrën e ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Gjermani;
- Nga janari 1998 e deri në gushtin e vitit 1999 subjekti i rivlerësimit ka punuar në institutin “****” në Heidelberg të Gjermanisë, duke përfituar për të gjithë periudhën 94.600 marka dhe është ftuar për të lektuar kundrejt pagesës në disa universitete të ndryshme në Gjermani;
- Nga shtatori i vitit 1999 dhe deri në dhjetor të vitit 2002, nga puna si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë ka gjeneruar shumën neto si pagë në vlerën 1.105.116 lekë;
- Nga janari 2000 deri në dhjetor 2002 subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumën si pagë neto në Shkollën e Magjistraturës në vlerën 286.230 lekë;
- Nga janari 1999 deri në dhjetor të vitit 2002, subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga qiraja e sendit të lëshuar të **** shumën 38.400 USD, apo 9.600 USD në vit;
- Nga dhjetori i vitit 1999 deri në dhjetor të vitit 2000, për 12 muaj, subjekti i rivlerësimit është paguar 600 USD në muaj nga qendra “****”, ku ka punuar si ekspert i së drejtës ndërkombëtare, duke u paguar në total 7.200 euro;
- Më datë 28.12.2000, subjekti i rivlerësimit ka marrë licencën e avokatit dhe e ka ushtruar këtë profesion në disa raste, duke dhënë konsulencë për persona fizikë, shoqëri tregtare të huaja dhe shqiptare, kryesisht në Gjermani dhe Austri;
- Subjekti i rivlerësimit është paguar 200 euro në muaj për periudhën maj 2001 - tetor 2002 si konsulent i z. C. V., drejtor për vendet e Ballkanit në Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Drejtësisë (***);
- Subjekti i rivlerësimit ka krijuar në vitin 2000 “Institutin e së drejtës”, si organizatë joqeveritare, duke organizuar aktivitete dhe duke përfituar financime prej tyre nga organizata dhe fondacione të ndryshme;
- Me fondacionin “****” deri në fundin e vitit 2002 subjekti i rivlerësimit ka kryer 9 seminare mbi legjislacionin zgjedhor, duke përfituar 98.000 lekë;
- Gjatë periudhës gusht 1998 e deri më 31 dhjetor 201 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar pranë shoqërisë “****”, duke përfituar pagën neto në vlerën 429.421 lekë.

Komisioni konstaton se të ardhurat nga kursimet e çdo viti kanë kaluar si likuiditete në vitet pasuese dhe janë deklaruar rregullisht ndër vite. Nga këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur vazhdimisht një shumë të konsiderueshme *cash*, e cila ka shërbyer për shpenzimet operative familjare dhe se pjesa tjetër e të ardhurave është depozituar rregullisht në bankë, qoftë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, që do të thotë në përgjithësi të bashkësisë ligjore.

40. Gjatë fazës së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar edhe se:

- 1) Nuk janë deklaruar të ardhurat e plota, nga dhënia e ambienteve të pasurisë së paluajtshme me qira për periudhën që pretendohet nga subjekti para vitit 2001, kur është bërë edhe kalimi i pronësisë për pasuritë e paluajtshme të sipërcituara. Por, edhe për vitet 2001-2003 rezultojnë vetëm kontrata të pronares, **znj. M. H.**, e cila si pronare e vetme e pasurisë prej 250 m², por pa specifikuar numrin dhe të dhënat e pasurisë, ka lëshuar me qira këtë pasuri. Rezulton vetëm një deklaratë e saj, në maj të vitit 2016, ku thekson se me pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, ka lëshuar me qira ambientet për vitet 2001 - 2003 me sipërfaqe prej 250 m².
- 2) Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka lidhur kontratë qiraje së bashku me 2 bashkëpronarë të tjerë më datë 20.09.2007, me afat 2 vjet, për pasurinë bodrum me sipërfaqe 150 m², por sipas të dhënave konstatohet se ka në pronësi një sipërfaqe prej 65 m² bodrum. Ndërsa në vitin 2010 lidhet kontratë tjetër 3-vjeçare pa noter (*përfundimi 17.03.2013*) me të njëjtët bashkëpronarë, por për një sipërfaqe prej 450 m². Gjithashtu, nuk specifikohet saktë numri i pasurisë përkatëse për këtë pasuri të dhënë me qira. Po për këtë pasuri, pa përfunduar afati 3-vjeçar (*i cili mbaronte në mars 2013*) është lidhur më datë 1.1.2012 një kontratë tjetër me afat 2-vjeçar (*pa specifikuar përsëri numrin e pasurisë, por vetëm sipërfaqen*).
- 3) Në vitin 2007 është lidhur kontratë qiraje midis 4 bashkëpronarëve, duke përfshirë subjektin e rivlerësimit, me shoqërinë “****”, me afat 2 vjet, nga data 01.10.2007 deri më datë 31.12.2009, me vlerë 300 euro në muaj. Për këtë rezulton një faturë për pagimin e vlerës së qirasë tetor - dhjetor 2007 në vlerën 810 euro, por nuk rezulton nëse është paguar qiraja dhe detyrimi për të ardhurat në burim nga qiradhënësi për të gjithë periudhën (01.10.2007 - 31.12.2009). Faturat e tjera të paraqitura janë të shoqërisë “****” dhe jo të shoqërisë “****”, e cila ka marrë me qira pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, nuk përcaktohen edhe të ardhurat nga qiraja vetëm për subjektin e rivlerësimit.
- 4) Në vitin 2010 është lidhur kontratë qiraje midis 3 bashkëpronarëve, duke përfshirë subjektin e rivlerësimit, me shoqërinë “****”, me afat 3 vjet, nga data 17.03.2010 deri më datë 17.03.2013, me vlerë 100.000 lekë në muaj. Për këtë nuk rezultojnë faturat e plota për pagimin e vlerës nga shoqëria “****” dhe as faturat e plota për pagimin e detyrimit të tatimit në burim. Faturat e tjera të paraqitura janë të shoqërisë “****” sh.p.k. Në vitin 2010 është bërë shtesë kontrate dhe vlera e qirasë mujore nga gushti 2010 bëhet 120.000 lekë në muaj. Gjithashtu, për të njëjtën periudhë dhe për të njëjtën pasuri, rezultojnë 2 kontrata qiraje, njëra e datës 17.03.2010 deri më datë 17.3.2013, dhe tjetra e datës 04.01.2012 deri më datë 31.12.2013, të dyja me shoqërinë “****”. Nuk përcaktohen qartë të ardhurat nga qiraja vetëm për subjektin e rivlerësimit dhe veprimet bankare për kalimin e shumës te subjekti i rivlerësimit.

Pjesa më e madhe e kontratave të qirasë janë bërë pa akt noterial, gjë që lë vend për dyshime dhe sidomos kur deklaratat e bëra nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen me dokumentacionin përkatës shkresor që ndodhet në dosje.

Lidhur me të ardhurat nga qiraja e njërive të shërbimit në pronën pasuri të paluajtshme pesëkatëshe, nga hetimi administrativ ka rezultuar se objekti ka përfunduar së ndërtuari në gusht të vitit 1997 dhe se nga ky moment ka qenë edhe funksional. Marrëdhënia juridike e qirasë ka lindur në shtator të vitit 1997 me subjektin “****”. Përbushja e detyrimit për pagimin e çmimit ka qenë dakordësuar me palët që të bëhej nëpërmjet bankës dhe se, duke qenë së në Shqipëri nuk ka pasur sistem të konsoliduar bankar në atë kohë, u zgjodh një bankë greke për depozitim të shumave të qirasë mujore nga pala qiramarrëse.

Ka rezultuar se bashkëpronarët, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, për arsye operativiteti dhe mbarëvajtjeje të mënyrës se si do të përditësohej marrëdhënia juridike e qirasë, kanë rënë dakord verbalisht dhe me veprime konkludente që përfaqësimin e zakonshëm me palën qiramarrëse ta realizonte njëra nga bashkëpronarët, konkretisht znj. M. H. Ajo ka realizuar kontaktet e herëpashershme me palën qiramarrëse, ajo kryente tërheqjet e shumave mujore të qirasë dhe më tej i ndante ndërmjet secilës familje bashkëpronare në përpjesëtim të pjesëve takuese. Ndërkohë, sikurse është konkluduar më lart, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit bashkë me bashkëshorten, si pjesë dhe kontribut në bashkësinë ligjore, kanë filluar ta përfitojnë drejtpërdrejt të ardhurën respektive nga qiraja në muajin janar 1999 e në vijim. Kjo, pasi shumat respektive të qirave të mëparshme, me pëlqimin e tyre, janë mbajtur nga bashkëpronarët e tjerë me qëllim për të kompensuar detyrimet nga ndërtimi, meremetimi dhe bërja funksionale e sendit të përbashkët.

Ajo që Komisioni mban parasysh është konkluzioni i mësipërm mbi momentin dhe mënyrën e fitimit të pronësisë mbi sendin e zhvilluar urbanisht, duke konkluduar sakaq se edhe marrëdhënia e qirasë ka nisur që në muajin shtator të vitit 1997 dhe ka vijuar më tej, sipas të dhënave që ka deklaruar subjekti i deklarimit.

Komisioni mban parasysh se likuiditetet e përfituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit janë shpenzuar sipas nevojave familjare dhe se tepricat e tyre janë depozituar në bankë, çka shpjegon edhe ligjshmërinë e krijimit të burimeve të pasurisë më vonë dhe të analizuara në këtë vendim. Komisioni mban parasysh se në çdo vit, sipas të dhënave të dosjes së hetimit dhe ato që subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion, ai ka pasur një bilanc pozitiv të të ardhurave, duke krijuar sakaq kursimet në llogaritë bankare dhe që kanë variuar nga viti në vit.

Lidhur me përbushjen e detyrimit ligjor për pagimin e tatimit respektiv mbi të ardhurat personale, Komisioni konstaton se në kontratat e qirasë, të administruara si provë, rezulton se palët kanë rënë dakord se detyrimin ligjor për të paguar tatimin mbi të ardhurat mbi shumat e çmimit mujor të qirasë, do të jetë në ngarkim të palës qiramarrëse. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer ndonjë shkelje ndër vite nga përfitimi i të ardhurave respektive nga qiraja, për t’u vlerësuar se ka shmangie të detyrimeve fiskale.

Komisioni mban parasysh interpretimin e drejtë të nenit D të Kushtetutës, ku përcaktohet se cila do të quhet pasuri e ligjshme dhe se kur subjekti i rivlerësimit shkarkohet si pasojë e konkluzionit se pasuria e tij/saj është e paligjshme. Në pikën 3 është parashikuar detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të shpjeguar bindshëm burimin e të ardhurave dhe pasurive dhe, më tej, e njëjta

pikë shquan si pasuri të ligjshme vetëm ato të deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet fiskale, duke i dhënë mundësi edhe ligjit për të shquar elemente të tjera përbërëse të pasurisë së ligjshme. Pika 4 parashikon se subjekti i rivlerësimit, që rezulton se ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, atëherë ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveç kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën. Kjo do të thotë se, së pari, jo çdo pasuri për të cilën s'është paguar detyrimi fiskal apriori duhet të kualifikohet si e paligjshme, pasi mundet që subjekti i rivlerësimit të shpjegojë bindshëm dhe të sjellë prova që vërtetojnë të kundërtën, që do të thotë se, megjithëse s'është paguar detyrimi fiskal për një pasuri, sërish burimi i krijimit të saj rrjedh nga një punë apo veprim juridik që ligji nuk e ndalon apo e lejon në mënyrë eksplicite. Nëse subjekti arrin të sqarojë dhe të provojë burimin e ligjshëm të së drejtës apo detyrimit që ka gjeneruar këto të ardhura apo pasuri, atëherë prezumimi kushtetues dhe ligjor sipas nenit D të Kushtetutës rrëzohet dhe pasuria në optikën e organeve vendimmarrëse të procesit të rivlerësimit kalimtar duhet të kualifikohet si e ligjshme. E nëse ndodh që pasuria të vlerësohet dhe provohet e ligjshme, atëherë do të thotë se subjektit të rivlerësimit nuk mundet t'i caktohet një masë disiplinore sipas nenit D të Kushtetutës, apo sipas shkeljeve të gjetura në shtyllën e kontrollit të parë të procesit të rivlerësimit kalimtar, konkretisht të kontrollit të pasurive. Në këtë mënyrë, mospagimi i detyrimeve fiskale, pa vërtetuar paligjshmërinë e pasurisë, nuk mundet të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të kësaj dispozite kushtetuese dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj. Mospagimi i detyrimeve fiskale mundet të konsiderohet apo të kualifikohet si shkelje e etikës së magjistratit apo si shkelje administrative sipas parashikimeve respektive ligjore, por jo si shkak për të aplikuar masa disiplinore sipas nenit D të Kushtetutës.

Duke sjellë në vëmendje konkluzionet që u arritën më lart, mbi mjaftueshmërinë e burimeve të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe bashkësisë ligjore të tij dhe bashkëshortes dhe, duke sjellë në vëmendje konkluzionin se të gjitha burimet e pasurisë së tij rrjedhin ose nga puna e ligjshme, ose nga marrëdhëniet kontraktore të ligjshme, atëherë konkludohet se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave dhe të pasurisë së deklaruar. Duke qenë se nuk ka pasuri të padeklaruara dhe duke qenë se u arrit të shpjegohet dhe të vërtetohet ligjshmëria e pasurisë së deklaruar, Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ i kryer nuk u arrit të gjenden shkelje sikur ato që Kushtetuta dhe ligji parashikon për procesin e rivlerësimit kalimtar.

41. Subjekti ka deklaruar shpenzimet për pagesën e shkollimit universitar dhe atij pasuniversitar për djalin R.Z., për periudhën 2008 - 2013.

41.1 Për të vërtetuar deklarinimet, subjektit iu kërkua të depozitonte dokumentacionin përkatës nga universitetet “***” dhe “***”; kontratat e qirasë për akomodimin gjatë periudhës së studimit; historikun e transaksioneve bankare dhe të gjitha llogaritë bankare në emër të R.Z:

“ Mund të deklaroni se sa kanë qenë të gjitha shpenzimet e tjera të jetesës, të mbuluara nga ana juaj për këtë periudhë?

Për sa më sipër, ju lutemi të provohen nëpërmjet dokumentacionit përkatës të gjitha faturat e lëshuara nga universitetet?

41.2 Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisionit rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar saktë shpenzimet në deklaratat e pasurisë ndër vite për shkollimin e djalit, ku rezultoi:

- Në vitin 2010, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollën në vlerën 12.500 paund;
- Në vitin 2011, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollën në vlerën 13.200 paund;
- Në vitin 2012, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollën në vlerën prej 17.500 paund;
- Në vitin 2013, subjekti ka deklaruar shpenzime për shkollën në vlerën 7.500 paund.

Këto deklarime të bëra ndër vite nga subjekti nuk përkojnë me deklaratimet e subjektit pas pyetjeve të bëra. Vetëm për vitet 2010 - 2011 ka një diferencë mosdeklarimi të shpenzimeve të kryera në vlerën prej 12.251 paundësh (*me kursin e këmbimit të kohës rreth 2.000.000 lekë*). Duke konsideruar se periudha e shkollimit të djalit të subjektit është në vitet 2008 - 2013, vlera e shpenzuar dhe e padeklaruar e subjektit të rivlerësimit është shumë më e madhe. Subjekti ka pasur dhe ka detyrimin ligjor të deklarojë të gjitha shpenzimet e kryera dhe në mënyrë të saktë.

Komisioni konstaton se ka mospërputhje ndërmjet deklaratave të pasurisë periodike të viteve 2009, 2010 dhe 2011, me deklaratën e pasurisë së dorëzuar nga subjekti për efekt të procesit të rivlerësimit. Ajo që konstatohet është se disa shpenzime, që kalojnë edhe shumën 500.000 lekë, edhe 300.000 lekë, si kufij ligjorë të detyrimit të subjekteve për të deklaruar shpenzimet, nga subjekti i rivlerësimit nuk janë përfshirë në deklaratat respektive periodike të pasurisë së dorëzuar në ILDKPKI. Por, të gjitha këto shpenzime të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit janë përfshirë në deklaratën e pasurisë së dorëzuar për procesin e rivlerësimit. Kjo do të thotë, në optikën vlerësuese të Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur pasuri në deklaratën objekt kushtetues shqyrtimi. Jo vetëm kaq, por konstatohet se ai ka dorëzuar vullnetarisht edhe gjendjet, edhe historikun e llogarive bankare, nga ku janë kryer transfertat e parave për shkollimin e djalit, R. Z.

41.3 Për Komisionin, mbetet të konkludohet nëse përbën shkelje të Kushtetutës dhe ligjit fakti që subjekti i deklarimit të pasurisë në disa deklarata periodike nuk ka deklaruar disa shpenzime dhe të ardhura, - që ka qenë i detyruar sipas ligjit për t'i përfshirë në deklaratën e pasurisë, - nëse përbën shkelje, - a ka në këtë rast fshehje apo mosdeklarim të pasurive sipas nenit D të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, kur rezultoi se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar me përpikëri të gjitha këto të ardhura dhe shpenzime në deklaratën e pasurisë të dorëzuar për qëllimet e procesit të rivlerësimit kalimtar?

Për të dhënë zgjidhje të kësaj çështjeje juridike, nga e cila varet konkluzioni i Komisionit, mbetet të sillen në vëmendje neni D i Kushtetutës. Kjo dispozitë parashikon se:

“1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë, sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”.

Në zbatim të kësaj norme kushtetuese kanë detajuar edhe dispozitat respektive të ligjit nr. 84/2016 dhe Komisionit, duke mbajtur parasysh të bëjë një interpretim logjik të këtij kuadri normativ, vlerëson se duhet të kuptohet se qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të funksionarëve të drejtësisë nuk është të vlerësojë dhe të hetojë nëse subjektet e rivlerësimit ndër vite kanë kryer ndonjë kundërvajtje administrative apo shkelje sipas ligjit për deklarimin e pasurive fillestare apo periodike, të cilat normalisht dhe natyrisht kanë qenë objekt i hetimit dhe verifikimit nga organe të tjera kompetente, konkretisht nga ILDKPKI-ja, të cilat kanë funksionuar si organe të përhershme dhe të zakonshme të vlerësimit të pasurisë së funksionarëve publikë. Përkundrazi, Komisioni vlerëson se qëllimi i këtij procesi është të vlerësohet nëse gjyqtarët kanë fshehur pasuri, nëse nuk e kanë deklaruar atë dhe nëse e justifikojnë ligjërisht pasurinë e deklaruar, sipas Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe sipas ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, me ndryshimet kushtetuese dhe po ashtu me ligjin nr. 84/2016, u krijuan Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, si organe të jashtëzakonshme, *ad hoc*, me juridiksion të kufizuar dhe të kushtëzuar në kohë dhe në lëndë shqyrtimi. Këto organe kanë detyrën kushtetuese dhe ligjore për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me tre elementë: pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale.

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, në zbatim të nenit D të Kushtetutës, këto organe kanë si objekt të vlerësojnë nëse subjektet e rivlerësimit kanë fshehur pasuri (*nuk e kanë deklaruar atë*), apo nuk justifikojnë ligjërisht pasuritë e deklaruara dhe për efekt të këtij procesi, subjektet e rivlerësimit do të plotësonin **një deklaratë të re**, të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pasurisë së tyre, burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe dokumenteve justifikuese (*shih nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 30 dhe 31 të ligjit nr. 84/2016*). Pra, objekt kontrolli nga ana e organeve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi do të ishte **vetëm** Deklarata-Vetting dhe jo deklaramet e bëra ndër vite nga subjektet e rivlerësimit.

Kjo do të thotë se, vlerësimin nëse ka pasur mosdeklarim apo mosjustifikim të pasurisë nga subjektet e rivlerësimit, këto organe sipas ligjit do ta bënin ekskluzivisht vetëm në raport me

Deklaratën - Vetting dhe jo në raport me deklaratimet ndër vite të funksionarëve publikë, sipas ligjit për deklarimin e pasurive. Në të kundërt, nuk do të kishte kuptim detyrimi kushtetues dhe ligjor i subjektit të rivlerësimit që të bënte një vetëdeklarim të ri, gjithëpërfshirës dhe të detajuar të pasurisë me qëllim rivlerësimit kalimtar të tyre, por do të mjaftonte që organet *ad hoc* të rivlerësimit të mblidhnin deklaratat ndër vite të këtyre subjekteve dhe të vlerësonin nëse ka shkelje të ligjit nga ana e tyre apo jo në lidhje me deklarimin e pasurive.

Sikurse u konkludua edhe më lart, Komisioni vlerëson se organet e rivlerësimit kanë juridiksion të kufizuar dhe të jashtëzakonshëm dhe nuk mund të kuptohen si organe që i mbivendosen apo dublojnë me efekt prapaveprues organet administrative të përhershme me juridiksion të zakonshëm të vlerësimit të pasurisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo do të thotë se organet *ad hoc* të rivlerësimit kalimtar kanë juridiksion ekskluziv të vlerësojnë vetëm shkeljet sipas ligjit nr. 84/2016, në bazë të Deklaratës-Vetting dhe jo shkeljet e tjera që mund të jenë kryer ndër vite nga subjektet e rivlerësimit, në bazë të deklarimeve të mëparshme, të cilat potencialisht mund të përbëjnë kundërvajtje administrative (*nëse nuk janë parashkruar*), sipas ligjit për deklarimin e pasurive dhe për vlerësimin e të cilave ndër vite juridiksionin ekskluziv e ka pasur ILDKPKI-ja si organ i përhershëm me juridiksion të zakonshëm. Interpretimi i kundërt do të vinte ndesh me parimin kushtetues dhe të përbotshëm të shtetit të së drejtës, konkretisht me parimin e vazhdimësisë së shtetit dhe vazhdimësisë institucionale, sepse do të nisej nga prezumimi i mosfunksionimit ndër vite të shtetit dhe institucioneve të tij.

Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se juridiksioni kushtetues dhe ligjor i saj kushtëzohet dhe mjaftohet me kontrollin e Deklaratës - Vetting të subjektit të deklarimit. Nga kontrolli i saj rezulton se subjekti i deklarimit ka pasqyruar me detaje çdo të ardhur të shpenzuar gjatë viteve 2008 - 2013 për studimet e djalit, R. Z., në Angli. Kjo do të thotë se subjekti i rivlerësimit nuk ka fshehur apo ka deklaruar çdo të ardhur të detyrueshme nga ligji për t'u deklaruar në Deklaratën e Pasurisë - Vetting. Kjo do të thotë se pika 3 e nenit D të Kushtetutës, në pjesën e prezumimit absolut të fajësisë së subjektit të rivlerësimit, konkretisht në pjesën e mosdeklarimit apo fshehjes së pasurisë, është irrelevante në çështjen objekt gjykimi.

Lidhur me prezumimin relativ ligjor të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, konkretisht pjesa tjetër dhe kumulative e pikës 3 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se, ashtu sikurse ka konkluduar edhe më sipër në arsyetimin e këtij vendimi, subjekti dhe bashkëshortja, apo thënë ndryshe bashkësia ligjore ndër vite, ka pasur likuiditete dhe të ardhura të mjaftueshme dhe të krijuara në mënyrë të ligjshme sa për të mbuluar shpenzimet. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se në rastin konkret nuk mundet të arrihet në konkluzionin se ka shkelje dhe shkak kushtetues dhe ligjor për të mos konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori.

42. Nga informacioni i marrë në rrugë zyrtare nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. ***, datë 21.12.2017, është konfirmuar se bashkëshortja e subjektit ka qenë anëtare e këshillit mbikëqyrës në shoqërinë “***”, shoqëri e cila figuron më pas e çregjistruar në vitin 2009. Nga ekstrakti historik i kësaj shoqërie figuron se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka ushtruar funksionet e anëtares së këshillit mbikëqyrës të kësaj shoqërie

aksionere, deri në mbylljen e shoqërisë në vitin 2009, dhe për këtë i është kërkuar shpjegim subjektit.

42.1 Në lidhje me këtë, subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me pozicionin e bashkëshortes sime si anëtare e këshillit mbikëqyrës në shoqërinë “***”, sipas shpjegimeve të saj, në datën 09.10.2002 ajo është caktuar nga asambleja e ortakëve të kësaj shoqërie si anëtare e këshillit mbikëqyrës. Pas gjashtë muajve nga ky emërim, nisur nga fakti që shoqëria nuk po fillonte aktivitetin e, për pasojë, këshilli nuk arriti të mblidhej asnjëherë, duke mos pasur kështu asnjë përfitim financiar, ajo vendosi t’i bëjë kërkesë shoqërisë për largimin e saj nga ai pozicion. Kjo kërkesë u miratua dhe, që nga data 19.04 2003, bashkëshortja ime shkëputi çdo marrëdhënie me këtë shoqëri. Për sa i përket faktit që emri i bashkëshortes sime vazhdon të figurojë si anëtare e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë “***” deri në vitin 2009, ka qenë detyrë e shoqërisë “***” të pasqyronte vendimin e asamblesë së saj për ndryshimet në Këshillin Mbikëqyrës, në regjistrin e shoqërive tregtare (bashkëngjitur deklarata e administratorës së shoqërisë, shih doc. 15).”*

42.2 Arsyetimi ligjor

- Nga hetimi dhe gjykimi i çështjes, pasi u analizuan edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, u konkludua nga ana e Komisionit se në të vërtetë, pas gjashtë muajve nga emërimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. N. Z., si anëtare e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tregtare, ajo ka vendosur t’i bëjë një kërkesë shoqërisë për largimin nga ai pozicion. Rezulton se kjo kërkesë është miratuar nga ana e shoqërisë dhe se që nga data 19.04 2003 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka shkëputur çdo marrëdhënie me këtë shoqëri.
- Në këto kushte, Komisioni konkludon se efektet juridike të shkëputjes së marrëdhënies juridike të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga shoqëria kanë ardhur me vërtetimin e faktit juridik të miratimit të kërkesës për dorëheqje nga ana e shoqërisë, që do të thotë data 19.04.2003. Kështu, edhe ky konstatim nuk passjell evidentimin dhe konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje nga ato që parashikon neni D i Kushtetutës. Ka qenë detyrë e shoqërisë për të kërkuar ndryshimin e publikimeve në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me vendimet e saj.

43. Në deklaratën periodike për vitin 2005 dhe për vitin 2006, subjekti nuk ka deklaruar llogari rrjedhëse në emër të bashkëshortes në vlerën prej 578.800 lekësh dhe në vlerën prej 1.199.400 lekësh, - e konfirmuar nga banka “Intesa Sanpaolo”.

43.1 Për këto i është bërë pyetje subjektit, i cili ka deklaruar:

“Dua të sqaroj se, në deklaratat vjetore për ILDKPKI-në është raportuar rregullisht për çeljen dhe shtesat e depozitave bankare dhe jo për llogaritë rrjedhëse. Në llogaritë rrjedhëse pasqyrohen të gjitha veprimet që realizohen gjatë gjithë vitit përmes transfertave bankare. Pjesë kryesore e këtyre veprimeve janë pagat e punësimit apo pagesa nga aktivitete të tjera të ligjshme, të cilat raportohen në zërat e tjerë të deklaratës vjetore. Raportimi i gjendjes së llogarive rrjedhëse në çdo fundviti është kërkuar dhe është bërë nga ana ime në vazhdimësi, duke filluar

nga marsi i vitit 2009 (për vitin 2008). (Shih deklaratën për vitin 2008, faqe 4, pikat 11, 12, 13). Në rastin konkret, shuma prej 578.000 lekësh në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes, në fund të vitit 2005, vjen nga pagat e punësimit në shoqërinë private (të deklaruara në deklaratën vjetore të vitit 2006), ndërsa pjesa tjetër nga transfertat bankare për shkak të veprimtarisë së saj si notere (edhe kjo e deklaruar si pjesë e fitimit të bashkëshortes për shkak të kësaj veprimtarie, në të njëjtën deklaratë).

Për vlerën e padeklaruar prej 1.199.400 lekësh, në thelb është i njëjti sqarim si më sipër, me ndryshimin se vlera prej 1.199.400 lekësh në fund të vitit 2006 në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes vjen kryesisht për shkak të transfertave bankare nga veprimtaria e saj si notere. Kjo shumë është deklaruar në deklaratën vjetore të vitit 2007 si pjesë e fitimit të saj vjetor nga kjo veprimtari (shih deklaratën e vitit 2007).”

43.2 Gjatë fazës së hetimit administrativ nga Komisioni është vërtetuar se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë bankare të bashkëshortes në deklaratën periodike të pasurisë për këto vite. Veprimet bankare janë kryer nga subjekti si të ardhura të fituara nga aktiviteti, ku më pas kjo llogari është mbyllur dhe vlera e krijuar është depozituar në llogari bankare në formën e depozitës. Subjekti ka qenë korrekt në deklarimin e të ardhurave të tij dhe bashkëshortes, sipas zërave përkatës, në deklarimet periodike.

44. Në deklaratën periodike për vitin 2007 është konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar hapjen e llogarisë rrjedhëse në emrin e tij në vlerën prej 747.824,33 lekësh, kjo e konfirmuar nga “Raiffeisen Bank” sh.a.

44.1 Arsyetimi ligjor

- Pas shqyrtimit në seancë, Komisioni konstaton se sqarimi i subjektit të rivlerësimit është i mbështetur në provat në dosje dhe, si i tillë, është bindës. Rezulton se edhe këto të ardhura të gjetura në llogari rrjedhëse, edhe pse llogaria nuk është deklaruar në vetvete nga ai, ka pasur deklarime të detajuara për burimet e krijimit të tyre. Rasti është i njëjtë, sikurse te konstatimet e mosdeklarimeve të dy llogarive rrjedhëse të bashkëshortes si person i lidhur. Kështu, nga analiza e akteve të dosjes, Komisioni konstatoi se në llogaritë rrjedhëse janë mbledhur të gjitha të ardhurat nga të gjitha veprimtaritë akademike dhe profesionale të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit, i cili për secilën prej tyre ka deklaruar burimin në deklaratat e pasurisë, duke individualizuar dhe sqaruar çdo transfertë nga të tretë. Në rastin konkret, konstatohet se bëhet fjalë kryesisht për kalimin në dy llogaritë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit të pagës nga puna; pagesave nga mësimdhënia në Fakultetin e Drejtësisë; Shkolla e Magjistraturës; pagesave nga mësimdhënia dhe aktivitetet akademike në universitete private; pagesa nga anëtarësia në KALSh pranë Ministrisë së Arsimit; pagesa nga anëtarësia në Komisionin e Reformës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë; pagesa nga konferenca e seminare, etj.
- Nga kjo analizë dhe nga këto konstatime, Komisionit i rezulton se edhe në këtë rast nuk mundet të konkludohet mbi shkelje nga ato që parashikohen në nenin D të Kushtetutës.

45. Në Deklaratën - Vetting është deklaruar se djali i subjektit, R.Z., ka përfituar të ardhurat nga mësimdhënia në vitin 2015 - 2016 në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës dhe universitetit “****”.

45.1 Në përgjigje të pyetjeve, subjekti ka deklaruar se të ardhurat janë krijuar nga burime të ligjshme, duke respektuar oraret dhe procedurën e përcaktuar në VKM 511, datë 24 tetor 2002. *“Është marrë leja e titullarit të institucionit dhe janë zëvendësuar orët respektive brenda javës. Mësimi në Fakultetin e Drejtësisë është dhënë vetëm në një semestër në vit (pra në rreth 14 javë) në katër orë të njëpasnjëshme (2 x 2 orë mësimore), duke shkuar në Fakultet normalisht vetëm një herë në javë gjatë një periudhe prej rreth tre muajsh e gjysmë në vit. Nga ana tjetër, mësimi te “****” në çdo rast është dhënë pas orarit zyrtar të punës, pra pas orës 16:00, ose në fundjavë.”* Subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues për miratimin nga titullari i institucionit dhe vërtetimin nga universiteti “****” për dhënien e mësimin pas orarit zyrtar.

46. Në Deklaratën-Vetting subjekti ka deklaruar të ardhura nga instituti gjerman me vlerë rreth 94 mijë marka gjermane, por këto të ardhura nuk i ka deklaruar as në Deklaratën e Fillimit të Detyrës në vitin 2003 dhe as në deklaratat e pasurisë në vitet pasuese.

46.1 Në përgjigje të pyetjeve, subjekti ka deklaruar: *“Për vitin 2003 nuk më është kërkuar të deklaroj edhe të ardhurat, edhe shpenzimet në vite nga punësimi apo aktivitete ose angazhime të ndryshme personale, profesionale apo familjare. Kam deklaruar gjendjen dhe pasurinë ekzistuese dhe mënyrën e përfitimit të saj. Është fakt shumë i qartë dhe i verifikueshëm lehtësisht që unë kam punuar pranë institutit “****” për të drejtën ndërkombëtare dhe kushtetuese në Heidelberg të Gjermanisë, nga janari i vitit 1998 deri në fund të gushtit 1999. Jam kthyer në Shqipëri në fillim të tetorit 1997 nga shërbimi në Ambasadën Shqiptare në Gjermani (gusht 1992 - tetor 1997) dhe pasi qëndrova më shumë se dy muaj pa punë, m’u ofrua mundësia për të punuar në institutin “****” në Heidelberg, ku kisha qenë edhe më parë (fillimi i tetorit – mesi i dhjetorit 1988; fillimi i prillit - fundi i qershorit 1991). Për këtë periudhë, janar 1998 deri në fund të gushtit 1999, jam paguar nga instituti në shumën 4.850 marka në muaj, në formën e bursës, pa asnjë detyrim tatimor. Ende sot, në dokumentet e mia zotëroj dy fatura të kësaj pagese mujore për muajt qershor dhe korrik 1999. Kohëzgjatja dhe qëndrimi janë konfirmuar edhe nga një prej bashkëpunëtorëve të vjetër të këtij instituti, z. M.H. Këto të dhëna mund të konfirmohen edhe nga drejtuesit e sotëm të institutit në fjalë, pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar dhe ndryshimit të personave. Angazhimet kryesore në institut kanë qenë: a) krimet e luftës në ish-Jugosllavi, si dhe gjendja dhe perspektiva e zgjidhjes së çështjes së Kosovës; b) risitë që sjell Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 në këndvështrim të parimeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, materializuar me botimin me të njëjtin titull në Shqipëri në vitin 2002 nga shtëpia botuese “****”; c) çështje të jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare, me fokus të drejtën ndërkombëtare detare (materializuar pjesërisht me botimin “Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare”, përmendur më sipër), e të tjera angazhime korente në institut për çështje të ndryshme të së drejtës*

*ndërkombëtare (shih doc. 17; 2 konfirmimet e pagesës nga instituti “****” për muajt qershor dhe korrik 1999).*

46.2 Arsyetimi ligjor

- Komisioni konstaton se për subjekti i rivlerësimit ka punuar dhe është angazhuar si kërkues dhe punonjës shkencor pranë institutit “****”, për të drejtën ndërkombëtare dhe kushtetuese, në Heidelberg të Gjermanisë. Periudha e këtij angazhimi ka qenë nga janari i vitit 1998 deri në fund të gushtit 1999. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë, me qëllim për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara në këtë periudhë, si pagesa për punën dhe kërkimin shkencor të kryer, vërtetimin përkatës. Nga informacioni që rezulton në këtë shkresë del se subjekti i rivlerësimit është paguar nga muaji janar 1998 e deri në fund të muajit gusht 1999 me shumën 4.850 marka në muaj, duke mos pasur detyrimin e pagimit të tatimeve, pasi konsiderohej dhe kategorizohej juridikisht si bursë shkencore dhe, për rrjedhojë, ishte e ardhur e patatueshme. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë si provë edhe dy fatura të kësaj pagese, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, konkretisht fatura e muajit tetor 1998 dhe korrik 1999, të administruara si prova në dosje.
- Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se shumatorja e të ardhurave të krijuara gjatë kësaj periudhe, në vlerën 94.000 marka, është deklaruar saktësisht nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e Pasurisë-Vetting dhe burimi i krijimit të saj është i ligjshëm. Mosdeklarimi i kësaj të ardhure në vitin 2003 nuk përbën shkelje, sepse detyrimi i deklarimit për herë të parë nuk parashikonte detyrimin për specifikimin e të ardhurave. Në vitin 2003 subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e pasurive të tij të ardhurat nga punësimi, ku përfshihet edhe kjo e ardhur, që ka përfituar nga bursa si punonjës shkencor në Gjermani.

47. Subjekti ka deklaruar shpenzime vjetore për djalin, M. Z., gjatë periudhës 2013 - 2016, pa provuar me dokumentacion mbështetës kostot e universitetit, të jetesës dhe kostot e qirasë.

47.1 Subjekti nuk ka deklaruar saktë të gjitha shpenzimet e kryera për shkollimin e djalit. Vetëm për vitin 2014, ka deklaruar shpenzime shkollimi në vlerën 9.000 euro, kurse sipas të dhënave të marra dhe dokumentuara nga veprimet bankare të kryera nga ana e subjektit, për vitin 2014, rezultojnë në vlerën 12.023 euro.

47.2 Arsyetimi ligjor

- Komisioni, nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe nga analiza e provave të administruara në dosje konstaton se subjekti ka deklaruar në Deklaratën e Pasurisë-Vetting se pagesa për semestër (dy të tillë në vit) për universitetin ku djali i tij shkollohet është rreth 120 euro dhe se nuk asnjë pagesë tjetër për universitetin; shpenzimet e jetesës, përfshirë edhe fjetjen, ku konvikti sigurohet nga universiteti për tri vitet e para, janë mesatarisht rreth 800 euro në muaj; pagesa e konviktit për tri vitet e para ka qenë 310 euro në muaj; garancia vjetore në bankë për çdo student të huaj ka qenë 8.000 euro; nga viti 2017 pagesë konvikti të ri në vlerën 621 euro në muaj. Rezulton se subjekti i

rivlerësimit ka deklaruar rregullisht në deklaratat vjetore dhe periodike transfertat e të ardhurave që ka realizuar për shkollimin e djalit, M. Z., konkretisht në llogarinë e tij në “Deutsche Bank”. Rezulton se M. Z. ka dy llogari bankare: a) një në “Deutsche Bank”, që e ka çelur në vitin 2013 dhe ku kryhen pagesat e nevojshme për studime nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë raportuar rregullisht në deklaratat e pasurisë vjetore në vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016; b) një llogari në “Sparkasse Bank”, ku ka të ardhurat individuale, e cila është çelur në vitin 2015 dhe ka gjendje 1.500 euro, e deklaruar në Deklaratën e Pasurisë së vitit 2015.

- Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar historikun e llogarisë dhe transfertave nga “Raiffeisen Bank” sh.a., me të cilën provon çdo shumë të shpenzuar për studimet e djalit, e nxjerrë në fundin e vitit 2017. Nga kjo e dhënë provohet vërtetësia, saktësia dhe burimi i ligjshëm i shpenzimeve të kryera për studimin e djalit. Për rrjedhojë, Komisioni konkludon se, në kuptim të nenit D të Kushtetutës nuk mundet të konkludohet se ka shkelje dhe nuk ka as vend për konstatimin fajtor dhe zbatimin e masave disiplinore për gjetjet e evidentuara gjatë hetimit administrativ.

48. Konkluzion përfundimtar për vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të administruar, deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit, rezulton se subjekti ka pasaktësi dhe mospërputhje të deklarimeve të mëparshme me Deklaratën-Vetting.

Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore, është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklaratime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës-Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Duke analizuar gjetjet e mësipërme, këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk u gjykuan si indice, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara apo fshehje të pasurisë.

Në këtë vlerësim u mbajt parasysh fakti që subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e bërë në Deklaratën-Vetting.

Më tej, Komisioni arsyeton se pasaktësitë në deklaratimet e viteve të kaluara nuk lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues,

kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës-Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë.

Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura ndër vite nga subjekti pranë ILDKPKI-së, mund të përdoren si provë nga Komisioni, bazuar në pikën 5 të nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, por këto prova duhet të analizohen në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të pasurisë. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Në këtë vlerësim, Komisioni mban parasysh edhe periudhën e rivlerësimit të këtij subjekti.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti Xhezair Zaganjori ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

49. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me nr. *** prot., datë 26.10.2017 (deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 30.01.2018), për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës.

Nga ana e DSIK-së, konform nenit 36 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”¹ është administruar informacioni që disponohet për subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese.

DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku në përfundim konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori.

A. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

¹ “Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës 1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e figurës për qëllim të këtij ligji. Personat që kryejnë kontrollin e figurës përmbushin standardet e zbatueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të konfidencialitetit në detyrë. 2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme krijojnë një grup pune për zbatimin e këtij ligji. Këto struktura mund të caktojnë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit. 3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji”.

50. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dosjeve të përzgjedhura me short, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2017.

Raporti është hartuar bazuar në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së;
2. Vlerësimin e denoncimeve dhe vendimeve gjyqësore të paraqitura në ankesat e subjekteve denoncuese;
3. Kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

50.1 Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i KLD-së është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, në 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

50.1.1 Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së, mbi dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet:

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, është nënshkruar në çdo fletë dhe është i rregullt nga pikëpamja formale. Subjekti nuk ka deklaruar adresë zyrtare.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se në periudhën janar 2003 - prill 2013, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese Tiranë. Nga prilli 2013 dhe aktualisht ushtron detyrën e kryetarit në Gjykatën e Lartë.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti ka deklaruar se në vitet 2013 - 2016 janë caktuar për shqyrtim gjithsej 955 çështje gjyqësore. Për këtë periudhë, subjekti ka në pritje për gjykim 1624 çështje. Gjatë kësaj periudhe ka miratuar dhe 1.210 dorëheqje.

d) Trajnimet në 3 vitet e fundit

Subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në 6 aktivitete trajnuese.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të llojit 2 vendime gjyqësore dhe 1 mendim pakice. Një prej këtyre vendimeve ka qenë i vitit 2015 dhe 2 vendimet e tjera të vitit 2014.

- Vendimi nr. ***, datë 04.04.2014 i Gjykatës së Lartë, paditës M.P. i paditur Gj.SH. Në këtë çështje subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues dhe relator. Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Teksti paraqitet me strukturë të qartë, i ndarë në pjesë dhe në paragrafë dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Në vendim parashtrihen çështjet për të cilat duhet të unifikohet praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve të tjera të ngjashme. Vendimi është i mirarsyetuar dhe me një gjuhë të qartë e të kuptueshme.
- Vendimi nr. ***, datë 22.1.2015, i Gjykatës së Lartë, me palë paditëse shoqërinë “****”, palë e paditur ZVRPP Tiranë dhe Sarandë. Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Teksti paraqitet me strukturë të qartë, i ndarë në pjesë dhe në paragrafë të panumërtuar dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.
- Mendim pakice për vendimin nr. *** i Gjykatës së Lartë, me palë paditëse shoqërinë “****”, palë e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në pakicë në këtë vendim gjyqësor. Ka paraqitur mendimin e tij mbi këtë çështje, duke analizuar vendimet e 2 gjykatave më të ulëta. Mendimi i pakicës është i mirarsyetuar, i qartë dhe i kuptueshëm dhe është respektuar rregullat e drejtshkrimit.

f) Dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Formularit i janë bashkëlidhur dhe 7 dokumente për pjesëmarrje në aktivitete trajnuese, dëshmi, dokumente e diploma.

50.1.2 Raporti i 5 dosjeve të subjektit të përzgjedhura me short

Gjetjet nga vëzhgimi i 5 dosjeve:

- Çështja administrative nr. ***, datë 03.07.2012, me objekt “Detyrimin e të paditurit të shpërblejë paditësit për mosrespektim afati të njoftimit, të ftesës për bisedime, për vjetërsi dhe për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës”.

Çështja pas rishortimit i kaloi subjektit më datë 4.11.2013 dhe është vendosur shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi më datë 22.10.2014, ditë kur është dhënë edhe vendimi. Arsyetimi i vendimit është bërë më datë 24.10.2014, pra dy ditë pas shpalljes. Dosja është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pas 1 muaji e 20 ditësh nga shpallja, duke shkelur afatin ligjor. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 11 muaj e 18 ditë, duke mos respektuar standardin e përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 (brenda 90 ditëve).

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit janë të qarta, të kuptueshme dhe pasqyrojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumentacioni i ndodhur në dosje është i rregullt, i plotë dhe i saktë nga pikëpamja formale.

- Çështja administrative nr. ***, datë 26.12.2011, me objekt “Kthim në punë dhe anulim urdhri për masë disiplinore të largimit nga puna”. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 26.12.2011 dhe pas rishortimit i kaloi subjektit më datë 11.11.2013, i cili ka vendosur shqyrtimin në dhomë këshillimi më datë 04.03.2014. Vendimi është dorëzuar i arsyetuar nga relatori më datë 23.04.2014, pra 19 ditë pas shpalljes, ndërsa dosja është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pas 2 muajsh e 9 ditësh, në tejkallim të afateve ligjore. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 vjet, 2 muaj e 6 ditë. Standardi kohor brenda 90 ditëve, i përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, nuk është respektuar.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit janë të qarta, të kuptueshme dhe pasqyrojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumentacioni i ndodhur në dosje është i rregullt, i plotë dhe i saktë nga pikëpamja formale.

- Çështja civile nr. ***, datë 30.04.2010 regjistrimi, me objekt “Detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer për humbjen pasurore në shumën 476.000 lekë”. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë më datë 30.04.2010 dhe pas rishortimit i kaloi subjektit më datë 11.11.2013, i cili ka vendosur shqyrtimin në dhomë këshillimi më datë 18.02.2014. Vendimi është arsyetuar nga relatori më datë 28.02.2014, pra 10 ditë pas shpalljes. Dosja është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pas 1 muaji e 8 ditësh, në tejkallim të afateve ligjore. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 vjet, 9 muaj e 19 ditë, në shkelje të standardit kushtetues “Gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor”.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Pjesa

arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit janë të qarta, të kuptueshme dhe pasqyrojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumentacioni i ndodhur në dosje është i rregullt, i plotë dhe i saktë nga pikëpamja formale.

- Çështja administrative nr. ***, datë 05.03.2014, me objekt “Kundërshtim akti administrativ dhe regjistrimin e pronës”. Çështja i kaloi subjektit më datë 05.03.2014. Më datë 06.01.2016 subjekti ka vendosur caktimin e seancës në dhomë këshillimi më datë 28.01.2016. Në këtë vendim nuk shënohet ora e seancës. Në dosje nuk ndodhet relacioni i ndihmësit ligjor, kërkesë e parashikuar nga neni 21 i ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000.

Arsyetimi i vendimit është bërë më datë 03.02.2016, pra 6 ditë pas shpalljes. Dosja është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pas 2 muajsh e 17 ditësh nga shpallja, duke shkelur afatin ligjor. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 10 muaj e 23 ditë, duke mos respektuar standardin e përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 (brenda 90 ditëve).

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit janë të qarta, të kuptueshme dhe pasqyrojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumentacioni i ndodhur në dosje është i rregullt, i plotë dhe i saktë nga pikëpamja formale.

- Çështja administrative nr. ***, datë 26.03.2015, me objekt “Kundërshtim akti administrativ dhe detyrimin e ZVRPP-së të regjistrojë pronën”. Çështja i kaloi subjektit me shortin e datës 17.12.2013. Më datë 05.03.2015, subjekti ka vendosur caktimin e seancës në dhomë këshillimi më datë 26.03.2015. Në dosje nuk ndodhet relacioni i ndihmësit ligjor, kërkesë e parashikuar nga neni 21 i ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000.

Arsyetimi i vendimit është bërë më datë 22.04.2015, pra 27 ditë pas shpalljes, në mosrespektim të afatit ligjor prej 10 ditësh. Dosja është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pas 2 muajsh e 28 ditësh nga shpallja, duke shkelur afatin ligjor. Gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit, 3 muaj e 9 ditë, duke mos respektuar standardin e përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 (brenda 90 ditëve).

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Pjesa arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit janë të qarta, të kuptueshme dhe pasqyrojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes, si dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Dokumentacioni i ndodhur në dosje është i rregullt, i plotë dhe i saktë nga pikëpamja formale.

50.1.3 Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

Subjekti i rivlerësimit nuk ka të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së, për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë.

50.1.4 Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit (i) formularit të vetëvlerësimit (ii) 5 dosjeve të përzgjedhura me short (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së (në rastin konkret nuk ka të dhëna nga KLD-ja).

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj. U kushton rëndësi rasteve të ndryshme dhe përdor parimet e përgjithshme të së drejtës. Subjekti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve, përdor referenca të jurisprudencës të Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese dhe i kushton rëndësi respektimit ose të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara janë të qarta dhe të kuptueshme. U kushton rëndësi vendimeve të ndërmjetme. Struktura e vendimeve përfundimtare është e standardizuar dhe arsyetimi është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e palëve. Në vendim ekziston lidhja e fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur subjekti.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në përbërje të kolegjit administrativ dhe kryetarit të Gjykatës së Lartë. Subjekti i rivlerësimit, për periudhën në 3 vitet e fundit, ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim 955 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 807, me një rendiment prej 84.5 %.

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Lartë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit subjekti ka përfunduar gjithsej 757 çështje gjyqësore, nga të cilat 605 çështje administrative dhe 152 civile. Nga analiza e 5 dosjeve, kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë në intervale kohore nga 3 muaj e 7 ditë deri në 1 vit, 10 muaj e 23 ditë. Ndër 5 dosje të vëzhguara, 2 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar ngarkesa sasiore. Në shumicën e rasteve, afatet ligjore të gjykimit janë tejkaluar. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, subjekti duhet të ketë bashkëveprim më të mirë me anëtarët e kolegjit për të shmangur vonesat.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, ku përgjithësisht seancat kanë qenë produktive. Në 5 dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short është konstatuar se përgjithësisht dosjet kanë qenë të rregullta dhe të plota. Për veprimet e kryera është mbajtur procesverbal gjyqësor. Në dy dosje është konstatuar mungesa e relacionit të ndihmësit ligjor. Në një dosje vendimi për caktimin e seancës nuk tregon orën e seancës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti në periudhën janar 2003 - prill 2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese, ndërsa për periudhën prill 2013 deri më sot ushtron detyrën e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo pakicave dhe nuk është konstatuar përdorimi i gjuhës diskriminuese, apo elementeve të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk është konstatuar që subjekti të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave në gjykim.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësia e komunikimit

Në 5 dosjet e vëzhguara në procesverbalin gjyqësor nuk ka dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar pa pjesëmarrjen e palëve dhe gjuha e përdorur në akte është normale.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Bashkëpunimi me administratën dhe anëtarët e trupit gjykues nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe depozitimin e dosjes.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit është angazhuar thellësisht në aktivitete profesionale. Ai i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Subjekti ka deklaruar se ka marrë pjesë në 18 takime dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë periudhës 2013 - 2016.

50.2 Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:

1. Denoncimi i z. Sh.S.;
2. Denoncimi i z. H.P.;
3. Denoncimi i z. B.B.;
4. Denoncimi i z. P.P.;
5. Denoncimi i z. V.B.;
6. Denoncimi i z. V.Ç.;
7. Denoncimi i z. A.N.;
8. Denoncimi u z. V.M.;
9. Denoncimi i z. H.H..

Ankesa 1.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 12.12.2017, shtetasi Sh.S., denoncon subjektin e rivlerësimit z. Xhezair Zaganjori, për korrupsion, shkelje ligjore, njëanshmëri të procesit.

Ankesa e denoncuesit, i cili është përfaqësues i S. G., është për subjektin A. D., gjyqtar i Gjykatës së Lartë, për të cilin ka kërkuar të hiqet dorë nga gjykimi i çështjes, ku është palë në gjykim. Sipas denoncuesit, ka bërë disa herë kërkesë te subjekti i rivlerësimit Xh. Zaganjori për të përjashtuar gjyqtarin A. D. nga shqyrtimi i çështjes. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se çështja nr. ***, me palë të paditur S. G. etj., rezulton te lista e çështjeve të ardhura për gjykim dhe pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë me relator gjyqtarin A. D.

Ankesa 2.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 20.11.2017, shtetasi H.P. denoncon subjektin e rivlerësimit lidhur me aftësitë profesionale.

Denoncuesi ka pasur një proces gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe pretendon se ndaj tij është dhënë një vendim i padrejtë lidhur me çështjen e pronësisë. Denoncuesi ka paraqitur vetëm një kërkesë ankimore, ku kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 08.06.2017, si vendim i pabazuar në dokumente reale, në fakte dhe prova. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur vendimin gjyqësor që përmend në ankesën e dërguar në Komision.

Ankesa 3.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 16.1.2018, shtetasi B.B. denoncon subjektin e rivlerësimit për aftësi profesionale, kontrollin e figurës dhe kontrollin e pasurisë. Në fakt, ky denoncues denoncon sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Sipas denoncuesit, si rezultat i korrupsionit dhe padrejtësive të gjykatave shqiptare, shumë çështje gjyqësore janë paraqitur pranë Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku janë dhënë me dhjetëra vendime në favor të shtetasve shqiptarë. Pra gjykatat shqiptare, dhe sidomos Gjykata e Lartë, ka dhënë vendime të padrejta që janë rrëzuar nga Gjykata e Strasburgut dhe për këtë duhet të rivlerësohen këta gjyqtarë të sistemit

të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Sipas denoncuesit, këta gjyqtarë duhet të dalin jashtë sistemit të drejtësisë dhe duhet të bëhet kontrolli i pasurisë, figurës dhe anës profesionale të tyre.

Ankesa 4.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 20.11.2017, shtetasi P.P. denoncon subjektin e rivlerësimit lidhur me aftësitë profesionale dhe zvarritje të procesit. Denoncuesi bashkëlidhur ka dërguar disa dokumente dhe ankesën e bërë në Gjykatën e Lartë. Me shkresën nr. ***, datë 06.11.2015, kancelari i Gjykatës së Lartë ka kthyer përgjigje duke i shpjeguar ankuesit se rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit duhet të bëhet brenda 30 ditëve dhe, në rast se ka kaluar ky afat, atëherë mund të kërkohet në gjykatë rivendosja në afat. Nuk evidentohet në dosje ecuria e mëtejshme e kërkesës për rivendosje në afat të denoncuesit.

Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit për shpifje dhe mashtrime me deklaratat që ka dhënë në media lidhur me kronologjinë e çështjeve që gjykohen në Gjykatën e Lartë, pasi faktikisht nuk janë gjykuar sipas rendit kronologjik në vite, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit.

Ankesa 5.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 12.12.2017, shtetasi V.B. denoncon subjektin e rivlerësimit lidhur me aftësitë profesionale dhe përfshirje në korrupsion. Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit se ka bërë dy rekurse në Gjykatën e Lartë dhe se janë tejkaluar afatet për shqyrtimin e rekursit nga kjo gjykatë. Gjithashtu, thekson se nga kjo gjykatë janë zhvilluar procese gjyqësore për rekurset e bëra nga subjektet e tjera që janë paraqitur më vonë se rekursi i denoncuesit.

Sipas verifikimit të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se çështja nr. ***, me palë V. B., rezulton te lista e çështjeve të ardhura për gjykim dhe pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë me relator gjyqtarin Sh.S.

Ankesa 6.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 12.12.2017, shtetasi V.Ç. denoncon subjektin e rivlerësimit për përfshirje në korrupsion.

Sipas denoncuesit, ai ka paraqitur disa rekurse në Gjykatën e Lartë lidhur me çështjen e tij penale dhe pretendon se janë zhdukur provat nga dosja e tij në Gjykatën e Lartë për qëllime fitimi. Denoncuesi kërkon të pyetet subjekti i rivlerësimit, se si kryetar i Gjykatës së Lartë, a ka dijeni për krim të organizuar ndaj denoncuesit, që po vazhdon të ushtrojë dhunë ndaj tij dhe familjarëve dhe nëse ka dijeni për dosjen e “mbrojtjes” me 50 prova të zhdukura nga kjo dosje, si dhe 3 - 4 dosje të tjera të zhdukura nga Gjykata.

Ankesa 7.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 12.12.2017, znj. A.N. denoncon, ndër të tjera, edhe subjektin e rivlerësimit për zvarritje në proces, aftësi profesionale, vendime në kundërshtim me ligjin.

Denoncuesja pretendon se ka bërë kërkesë pranë Gjykatës së Lartë disa herë lidhur me informimin e situatës për rekursin e bërë në këtë gjykatë dhe përse dosja mbahej e fshehur, në kuadrin e

transparencës dhe të drejtës së informimit, por nuk kanë marrë përgjigje nga subjekti i rivlerësimit dhe gjyqtari i çështjes, A. B.

Ankesa 8.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 18.01.2018, znj. V.M. denoncon subjektin e rivlerësimit për aftësi profesionale.

Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së bërë në Gjykatën e Lartë dhe kërkon mbajtjen e përgjegjësisë ligjore nga subjekti për veprime dhe mosveprime të tij. Gjithashtu, denoncon subjektin për parregullsi në regjistrimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, pasi çështja ku ajo është palë është regjistruar 2 muaj me vonesë nga data e dërgimit të dosjes nga Gjykata e Rrethit Lezhë.

Ankesa 9.

Me denoncimin nr. *** prot., datë 01.12.2017, shtetasi H.H. denoncon subjektin e rivlerësimit për përfshirje në korrupsion, vendim në kundërshtim me ligjin dhe bazuar në dokumentacion të falsifikuar.

Në denoncimin e tij, denoncuesi nuk ka përmendur emrin e subjektit të rivlerësimit, por ka përmendur disa subjekte të tjera dhe individë për të cilët ankohet se i kanë përvetësuar padrejtësisht pasurinë me anë të vendimeve gjyqësore ndër vite. Gjithashtu, nuk është paraqitur bashkëlidhur ndonjë vendim gjyqësor i Gjykatës së Lartë, ku të rezultojë subjekti i rivlerësimit si pjesëtar i trupit gjykues.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Xhezair Zaganjori, me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë.
- 2.** Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 24.07.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues

Relator

Anëtar

Olsi Komici

Pamela Qirko

Roland Ilia

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj